

# KOQËSUA RJA

**Ballina:** Juliana Nura  
**Foto:** Arton Humolli

**Ç'thotë  
nëna e dy  
dëshmorëve,  
Ryvë Ferizaj**

**Luftëtari  
shqiptar  
i Kroacisë  
kthehet  
në Shkabaj  
pas 15 vjet  
zhdukjeje**

*Rikthehet*  
**JULIANA  
NURA,**  
*më e fortë dhe  
më e bukur se kurrë*

**remos**

**DENTFIX**

**HELPER**  
GENÈVE

**SHERWOOD**  
Beauty and Health

**MARITIM**  
Beauty and Health

**allure**  
Beauty

**UB**  
UNION BUSINESS  
ALBANISCH & DEUTSCH

**DINO**  
CERAMICHE

**Shkabaj**  
FISH RESTAURANT

**MOLLA**

**Shkenda Dyben**  
Desserts and Sweets

**Banaderm**

**BREZOVICA**  
Ski Resort

**CIMA**  
CASA MODERNA DI ARREDI





# Kërkimi dhe Eksplorimi

Kërkimi dhe eksplorimi janë konceptet kryesore të një udhëtimi zbulimi përmes frymëzimeve të reja materiale. Nga Italia në Francë, nga Brazili në Meksikë dhe në Madagaskar, në kërkim të elementeve unike të bukura të përfshira në një enë me mermere ekskluzivë prej porcelani.

+383 49 566 667



[dino-company.com](http://dino-company.com)





Juliana Nura ishte dhe është sinonim i femrës së bukur, të zgjuar dhe ambicioze. Kishte tituj bukurie, pjesëmarrje në pasarela mode, dalje në kopertina revistash, intervista gjithandej dhe ishte bërë absolutisht femra më e ndjekur shqiptare në rrjete sociale. Gjithë nami i saj u shembë për një sekondë, kur në publik i përfundoi një video intime, e cila u shpërnda me shpejtësinë e dritës.

Juliana Nurës iu deshën shumë vite të triumfite mbi atë që u konsiderua si skandal i saj. 12 vjet jetë duke punuar me shëndetin mendor, duke u përpjekur ta gjente veten, synimet dhe ambiciet e saj të vërteta.

Vajza, e cila vite më parë kishte ardhur nga Universiteti i Helsinkit ta bënte një vit transfer studimesh në atë të Prishtinës, në Fakultetin e Mjekësisë, e që krejt papritur u gjet në botën e modës dhe u përfshi në një të ashtuquajtur skandal, sot është rikthyer më e fortë se kurrë, për veten dhe femrat e tjera që mund ta kenë pasur fatin e ngjashëm me të saj. Juli tash është grua e pjekur, e pamposhtur dhe më e bukur se asnjëherë më parë.

**Rikthehet Juli Nura,  
më e fortë dhe  
më e bukur se kurrë**



**Je njohur si mis, femër ambicioze e punëtore, që ke lënë gjurmë në mediet rozë të para disa viteve. Si ka qenë ajo kohë për ty?**

- Jam njohur si vajzë e zonja, e bukur, me shumë qëllime në jetë. Pata fituar titullin "Miss Diaspora", isha edhe në "Miss Finland".

Pastaj, u njoha me Fadil Berishën dhe nisa një rrugë të re në botën e spektakleve të bukurisë dhe modelimit në përgjithësi, ku edhe pata sukses. Gjithsesi, në jetën time asnjëherë këto gjëra nuk kanë qenë primare, pasi unë kisha për synim ta kryeja fakultetin e mjekësisë dhe të bëhesha daktreshë.

**Ju rridhni nga një familje që është marrë me biznes, apo?**

- Po, familja ime tradicionalisht është marrë me biznes dhe unë kam pasur gjithmonë dëshirë të jem e kyçur edhe në këtë fushë, andaj sot jam në botën e financave dhe biznesit dhe në sipërmarrje të ndryshme.

**Nëse ishe kthyer në kohë, a do të ishin spektaklet e bukurisë dhe pasaretat sërish zgjedhja jote?**

- Mendoj se gjithçka ndodh për një arsye. Nga 360 universitete që ka Finlanda, të japin mundësi për të bërë transfer, e unë e zgjedha Kosovën, sepse duket se kështu ka dashur Zoti, të sprovohem shumë dhe të bëhem aq e fortë sa një ditë të jem lider për gratë në botë, që përmes programeve të mija t'i mësojë se si të mos kalojnë nëpër ato që kam kaluar unë. Ose, nëse kalojnë, si ta gjejnë dashurinë dhe motivacionin përsëri për jetën e tyre.

**Sigurisht, dikur të kanë përmbushur komplimentet. Po sot si qëndron në këtë aspekt?**

- Me kalimin e viteve, gratë që e mbajnë veten, e vlerësojnë veten, arrijnë t'i afektojnë edhe më shumë njerëzit me bukuri, sharm, inteligjencë, sepse reflektojnë më tepër vetëbesim dhe dinë t'i nxjerrin më lirshëm në pah virtytet e veta.

Ndoshta kjo është edhe arsyeja pse unë marrë më shumë komplimente sot se dikur.

E vlerësoj, e respektoj, e dua veten me shumë se kurrë, sepse e di sa e vlefshme jam si person.

**Vërehet që ke punuar mjaft me vetëbesim. A mendon që je "on the top"?**

- Po, mendoj bindshëm që jam "on the top" në jetën time. Jeta është shumë e bukur, bekim nga Zoti. Nëse secili njeri bindet që jeta është dhuratë, atëherë do ta festojë ditëlindjen çdo ditë, siç bëj unë.

**A e ke pasur gjithmonë këtë këndvështrim për jetën?**

- Ata që më njohin e dinë se gjithmonë kam qenë njeri pozitiv, ani pse jeta nuk më ka rezervuar vetëm momente tepër të bukura.

**Me gjasë, po aludon në vitin 2010, atëherë kur në publik doli një video e juaja "intime". Si ishte ajo periudhë për ty?**

- Kjo ka qenë një periudhë mjaft e vështirë për mua sa i përket shëndetit mendor, pasi shantazhohesha dhe krejt kjo krijonte traumë.

**Nga kush u shantazhove, si ndodhi, çfarë bërë në atë kohë?**

- Isha e lidhur me një djalë dhe hyri një haker në bisedat tona private dhe e mori atë video dhe u shantazhova shumë për para, por prapë e hodhi videon në internet...

**Kjo gjë, sigurisht, la gjurmë në jetën tënde dhe ti u shpëputë nga të gjitha aktivitetet e asaj kohe. Si eci jeta jote tutje?**

- Mu desh të merresha me shëndetin tim mendor. Isha e dërrmuar, pasi isha vetëm 21-vjeçare dhe vija nga një familje mjaft tradicionale shqiptare.

Ndonëse e lindur dhe e rritur në Finlandë, për mua dhe familjen time ajo çfarë kishte ndodhur ishte gjë e madhe.

Kurrë nuk kam dashur të njihem për skandale, por si grua e fortë, lider, e mençur, e pse jo edhe e bukur. Ja që ndodhi...

Por, jam me fat që më ndodhi, sepse sot jam kjo që jam tash...

**Për më shumë se dhjetë vjet keni bërë një rrugë të gjatë të punës me vetveten, duke u kthyer më e fortë se kurrë. Ku je sot, ç'bën?**

- Kanë kaluar 12 vjet nga ajo kohë dhe më ka ndihmuar shumë "bordi i vizioneve", që ja kam bërë dhuratë vetes.

Kam arritur t'i realizoj shumë nga 10 pikësynimet e mija rreth asaj se kush do jem dhe çfarë do të bëhem.

Kam kryer mjekësinë, fakultetin e ekonomisë, kam hapur biznesin tim, kam punuar me shëndetin mendor dhe është tejet e rëndësishme që kam arritur t'u ndihmojë fuqishëm femrave që kanë kaluar nëpër



situata të ngjashme me ato të mijat, të cilat më shkruanin përditë, duke më pyetur se si ia kam dal unë dhe çfarë duhet të bëjnë ato...

### **Kështu, si duket, ka nisur edhe ideja e platformës tënde sot?**

- Gjithçka ka nisur si ndihmë drejtuar grave, që përmes ushtrimeve të fitnesit virtual të punojnë në drejtim të mirëqenies fizike dhe emocionale.

Para disa muajve kjo ide është shndërruar në platformë, duke konstruktuar fillimisht web sajtin dhe çdo gjë tjetër që duhet që ky projekt të funksionojë siç është më së miri.

### **Ky projekt quhet “Body, mind and soul”, që do të thotë se ngërthen në vete ushtrime që kontribuojnë në mënyrë shumë pozitive për trup, mendje dhe shpirt, apo?**

- Po, sepse, thonë se mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë. Unë jam trajnerja kryesore që do të punojë me gra nga e gjithë bota, por edhe gra nga të gjitha trojet shqiptare, që do të kenë mundësi të abonohen me një çmim shumë më solid.

Gratë do të bashkohen në ushtrime fizike, në mënyrë virtuale për katër herë në javë bashkë me mua. Dhe, një herë gjatë javës do të kemi biseda, kryesisht, me psikologë, me të cilët do të flitet për aspekte të ndryshme të shëndetit mendor. Edhe unë do të përpiqem që edhe në këtë një ditësh të sjellë përvojat e mia se si mundet një grua t'i kthejë problemet personale në forcë dhe kurajo.

### **Numri i grave pjesëmarrëse do të jetë i limituar?**

- Po, sepse nuk mund të marrim qindra mijëra gra, pasi secilës duam t'i japim kohën dhe vëmendjen e duhur.

### **Cili është “modeli” i gruas që është rast për t’u bashkangjitur në “Body, mind and soul” nga Juliana Nura?**

- Është ajo grua që dëshiron të bëhet më mirë. Nëse një femër, që ka kaluar diçka traumatike (siç kemi kaluar krejt në diçka të trishtë), atëherë bashkë do të bëjmë mrekulli.

### **Siç po e kuptoj, projekti yt është me karakter global, a?**

- Me gra nga vende të ndryshme të botës ka kohë që ka filluar puna. Kam të inkuadruara në projektin e fitnesit, mendjes dhe shpirtit gra angleze, suedeze, finlandeze, norvegjeze, polake etj. Kam disa shqiptare me të cilat po punoj për momentin dhe shumë shpejt do të rritet numri, falë abonimit më të lehtë në platformë.

### **Me gjithë këto punë e angazhime, a ke jetë private?**

- S’ka jetë private për momentin, ka shumë punë. Tani për tani një lidhje, fejesë, apo martesë është një plan pak më i largët.

Natyrisht, besoj në martesë dhe familje, andaj në të ardhmen shpresoj që të ndodhin edhe këto gjëra të bukura.

### **Ç’thonë e mendojnë prindërit sot për ty dhe punët që bënë?**

- Janë krenarë me mua dhe atë që bëjë. Nëna ime shpesh më thotë se ndihet krenare me mua dhe atë se si punoj me femrat e tjera, për t’ua bërë më të lehta sfidat nëpër të cilat kalojnë.

Njëjtë dëgjoj edhe nga shoqet, që thonë se janë me fat që e kanë një shoqe besnike, mbështetëse dhe të dashur.

### **Këshilla jote për femrat?**

- Kurrë mos u ndikoni nga mendimet e rrethit, qofshin ato edhe të familjes. Ecni përpara drejt realizimit të ëndrrave tuaja dhe realizimit të vetvetes. Bëhuni versioni më i mirë i vetes suaj! Dhe, mos lejoni të poshtëroheni, pavarësisht se çfarë u ka ndodhur në jetë...

### **E ardhmja?**

- Kam plane të mëdha për të ardhmen time, e që uroj të kem shëndet e t’i realizoj. Lidhen me platformën për të cilën folëm, biznesin, por edhe me zhvillimet në jetën time private.

### **Për fund?**

- Për mua ka rëndësi që kur përmendet emri im, Juliana Nura, njerëzve t’u vijë në mendje goca që nuk është trembur, nuk është mposhtur dhe nuk e ka poshtëruar asgjë në botë.

**N. Neziri**



# remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës  
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:  
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,  
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni ne [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)



[remos\\_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)

| [www.remios-restaurants.de](http://www.remios-restaurants.de)



# POPULLI S'HA BARË!



## JA SI LUFTOHEK...

Një grafist anglez, me emrin Riçard Koton, i njohur si artist dhe gazetar i regjioneve konfliktuale apo i sheshit të luftës, dy dekadat e fundit të shekullit XIX i ka kaluar në zonën kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë, duke nxjerrë mbi 30 mbishkrime bardh e zi me tematikë shqiptare.

Dhe, kudo në grafikët e tij sheh të portretizuar shqiptarin në skenat e ndryshme të jetës së luftës, të qytetit e fshatit, me historinë, doket dhe zakonet që e karakterizojnë. Kudo në skenat e egra të gjakmarrjes, të përleshjes trup me trup me armikun e deri në ndërtim urash e fortesash, në përgjim e përbetim për të mbrojtur lirinë me gjak dhe duke kënduar këngë trimash.

Pra, kudo shqiptari fatzi i luftës, i sakrificës, i mundit, i mbijetesës. E sheh të mbrojtë malet, duke zotëruar lartësitë e tyre, duke rrokullisur nga ato lartësi shkëmbinjtë, madje edhe veten, vetëm e vetëm për të mos e lëshuar, madje, as një pëllëmbë tokë.

E sheh të bërë njësh me malin, sup mbi sup të shoqi-shoqit, jetë e vdekje mbishtresuar, një kala të vërtetë për t'i shpënë perëndisë me-sazhin e shenjtë se edhe jetën e jep për tokën e tij të shenjtë dhe nuk e ka dert. Pikërisht këtë përmbajtje ka grafika e Kotonit, e vitit 1883, me titull "Ja si luftohet".

\*

S'di pse mu kujtua në këtë çast ky grafist i njohur, as pse mu dha ta përmendi, por ja që e vlen ta rikujtojë njeriu, të rikthejë shumëçka nga e kaluara për t'ia ditur vlerën së sotmes.

## NESËR, KU BUKA?

Në vendet e zhvilluara të botës, ruajtja e

tërësisë së tokës bujqësore, e asaj punuese dhe sigurimi i bukës, janë probleme strategjike, e që udhëhiqen e dirigjohen nga politika shtetërore. E, politika shtetërore jona ku është?

Është e pranishme një dyndje e pakontrolluar e popullatës, e paparë në historinë e Kosovës. Kjo ndikon që shumë toka bujqësore të shndërrohen në zona ndërtimi. Madje, edhe në tokat më të mira, më pjellore...

Se është kështu mjafton t'i hedhësh një shikim Rrafshit të Kosovës. E, mjerisht, ka edhe shumë shembuj të tjerë...

Megjithatë, toka nuk po shkatërrohet vetëm nga lëvizjet e pakontrolluara, por edhe nga pompat e benzinës, motelet, magazinat me hektarë të tërë, fabrikat prej betoni që nuk u shihet fundi.

Dhe, të gjitha këto janë ndërtuar dhe po ndërtohen në tokat më të mira bujqësore! Ndërkaq, kanë mundur të ndërtohen në zonat më pak bujqësore, kryesisht buzë maleve, ku toka shfrytëzohet shumë më pak.

Dhe, lind pyetja: A është menduar dhe a mendohet se si do të ushqehet populli në të ardhmen?

Shtetet e zhvilluara i vënë prita detit për të fituar tokë bujqësore, ndërsa ne e shkatërrojmë dhe e zvogëlojmë ditë e më shumë tokën e bukës!

\*

S'di pse edhe për këtë temë po shkruaj, kur dihet se asgjë s'mund të ndikojë, as ta ndalë! S'po mund ta ndalin as pushtetarët, të cilit sikur s'mendojnë as për fëmijët e tyre, se janë duke ua zënë frymëmarrjen për ditë e më shumë. Pak, a askund gjelbërim.

Gjithkund beton...

Gani Dili

# KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

**Dizajni:**

Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

*Nuk ka hajr as nga pushteti e as nga mileti...*

**Zbulimi i Pllakës përkujtimore të Haxhi, Agron dhe Skënder Ferizaj, nga fshati Kodrali i Deçanit**

# *Ç'thotë nëna e dy dëshmorëve,* **Ryvë Ferizaj?**

*Familjes Ferizaj, nga fshati Kodrali i Deçanit, pushteti serb ia vrau dy bijtë: Agronin, më 1984 dhe Skënderin, më 1999, kurse ia maltretuan bashkëshortin, Haxhiun, veteran i arsimit.*

Nënë Ryvën, në shtator të vitit 2013, e "vizitua" në shtëpinë e saj, ku e gjetëm të "rrethuar" nga nipat, mbesa, reja, nusja e nipit dhe stërnipi e stërmbesa...

"Djemtë e mi trimërinë e kishin të ngulitur në zemër, sepse babai i tyre, Haxhiu, mësues i parë i kësaj ane, ishte maltretuar disa herë nga UDB-a. Djemtë tanë e ndihmuar babanë e tyre në shtypjen e afisheve, në shpërndarjen e tyre te miqtë dhe shokët, në fshehjen e tyre dhe përjetuan bastisjet që iu bënë shtëpisë sonë me dhjetëra herë nga policia e kohës. Ata nuk e jetuan jetën e tyre rinore si të rinjtë e tjerë, sepse ishin të vëzhguar nga njerëz të porositur. Skënderi

dhe Agroni u burgosen, u rrahën dhe u maltretuan psikikisht nëpër burgjet serbe, por i qëndruan besnik atdheut deri në frymën e fundit. Agroni, duke mbrojtur dinjitetin e kombit, u burgos në ish-armatën jugosllave dhe shtatë javë para përfundimit të shërbimit ushtarak erdhi në shtëpi në arkivol, i vrarë më 1984.

Edhe përkundër dhembjeve të mëdha shpirtërore, sepse dhembje përjetonin fëmijët e mi, për inat të armiqve qëndrova guximshëm, ndershëm, fuqishëm, krenare dhe vazhdoj të jem e tillë", shprehet Ryvë Ferizaj (1933), nënë që lirisë së Kosovës ia dhuroi dy djemtë: Skënderin, i lindur më 1956, dhe Agronin, i lindur më 1957.

## **AS JETA E DJEMVE NUK ISHTE MË E VLEFSHME SE KOSOVA**

Ajo, përkundër ankesave që ka për qeveritarët në mungesë të ligjit për rastet e tilla, si dhe anashkalimin si familje nga pushtetarët, vazhdon të besojë se asgjë nuk është më e vlefshme se liria e Kosovës, as jeta e djemve të saj.

"Unë kurrë nuk e kam krahasuar jetën e bijve të mi me lirinë e Kosovës. Pa dyshim, më janë dhimbsur shumë se kanë hequr nëpër kazamatet e ish-Jugosllavisë.

Skënderi ka ardhur në 30 kg. dhe ishte vetëm 25 vjeç! Nuk e priti lirinë e



Kosovës, sepse u vra nga ushtria serbe më 1999.

Mandej, Agroni la nusen, shkoi për të kryer shërbimin ushtarak, u keqtrajtua shumë atje, por nuk u gjunjësua. Shkoi hisehumbur. Kur folëm për herë të fundit në telefon, më tha: "Nënë ma kanë pru situatën shumë ngushtë!". I thashë: "Biro, mos ke dert se ushtria ta bon qarën". Ai u përgjigj: "Ke me ia dëgjuar krismën ushtrisë!".

Dhe, në ditët në vijim përjetova gjënë më të dhimbshme që mund ta përjetojë një nënë. Por, sot me mburrje them se bijtë e mi ma kanë zbardhur fytyrën", shprehet e emocionuar bashkëbiseduesja jonë, Rylvë Ferizaj.

## TË THËNAT E TË PATHËNAT E NJË NËNË

"Qe 50 vjet jemi përballur me armikun e përbetuar të Kosovës. Pas shpërbërjes se kolektivizimit, afro pesë hektarë tokë që i kishte marrë shteti nuk na u kthyen kurrë! Burri kishte përfunduar studimet për arsim dhe ishte gjeneratë e Haxhi Ademit, Bajram Jonuzajt, Selman Istrefajt, Shaban Ramës, emra këta të dëshmuar të zhvillimit të arsimit shqip në Kosovë. Unë u martova në një familje gjashtë anëtarësh, me kushte mesatare, në vitin 1954.

Pas pesë vitesh martesë Haxhiu u bë drejtor i shkollës fillore "Vëllezërit Ribar" (tash "Asdreni") dhe ne shkuam për të jetuar atje.

Në vitin 1955 na lindi fëmija i parë, Hana, pastaj të tjerët: Skënderi, Agroni, Drita, Vjollca.

Gjatë asaj kohe Haxhiu ishte lidhur me një organizatë politike shqiptare që vepronte fshehurazi. Unë e kam kuptuar këtë kur Haxhiu ra ngushtë për t'i fshehur disa letra (afishe) dhe normalisht i ndihmova.

Pastaj, pasuan bastisjet e shtëpisë sonë nga policia, marrja në pyetje dhe keqtrajtimi i Haxhiut, përcjellja, frika e njerëzve për të ardhur te ne etj. Fëmijët tanë u rriten në këtë frymë. Haxhiu i dërgoi të dy djemtë në studime jashtë Kosovës, në Sarajevë. Skënderi studioi në shkencat matematikore, siç kishte bërë edhe babai i vet, ndërsa Agroni - veterininë. Megjithatë, kishim mall për ta se vinin rrallë në shtëpi, vetëm në gjysmë-vjetor.

Pa i përfunduar studimet Skënderin e martuam (1978), sepse i erdhi ftesa për ta kryer shërbimin ushtarak. Ai shërbimin ushtarak e filloi në Shkup, në vitin 1981, duke lënë në shtëpi bashkëshorten dhe djalin e vogël, Ilirin", rrëfen këtë pjesë të të jetuarit të familjes së saj, Rylvë Ferizaj, për të vazhduar: "Atje menjëherë kanë filluar ta përgjonin, ta etiketonin si njeri i dyshimtë, derisa kanë arritur edhe ta burgosin. Në fakt, pas shpërthimit të demonstratave në Kosovë, nga garnizoni i Shkupit i kishin mobilizuar 20 ushtarë për t'i sjellë në Kosovë.

Skënderi ka pyetur: "Ku po shkojnë ata?".

Njëri i kishte thënë: "Me vra shqiptarë!".

Atëherë, Skënderi nuk kishte mundur të përmbahej dhe u thotë: "Shqiptarët kanë lindur me pushkë në dorë dhe s'mundet me i mbytë askush!".

Kjo ka qenë arsyeja e fundit që është marrë në pyetje nga shërbimi sekret policor dhe pas gjashtë ditësh është burgosur.

Dhe, katër muaj nuk kemi ditur a është i gjallë a i vdekur. Pastaj, kemi shkuar dhe e kemi parë nga largësia, përmes disa mrezheve. Mezi rrinte në këmbë... Na shkroi letër Skënderi dhe tha se është mirë. Në anën tjetër të letrës edhe ne i shkruam se jemi mirë dhe kaq ishte nga ajo "vizitë".

Pastaj, unë dhe Haxhiu kemi shkuar shpesh, por çdo herë u përplaseshim me rigorozitetin e tyre, me enigmat rreth fatit të Skënderit, me gjendjen shëndetësore dhe pamjen e keqe të tij, me bisedat me përkthyes dhe të limituara.

E, kjo Haxhiut i solli sëmundje të pashëruar, me faktin se ishim në duar të tyre dhe duhej të heshtnim. Gjykimi i Skënderit zgjati pesë javë (Gjyqi Suprem i Maqedonisë) dhe përfundimi ishte shtatë vjet burg. Pas marrjes së vendimit policët e dërguan në burgun e Idrizovës. Në ato çaste iu drejtova policëve: "Ndaleni djalin!". Ata u ndalën. Skënderi i thashë: "Hajt djali jem, mos u friko, burgu është për burra!".

Gjatë vuajtjes së dënimit Skënderin e kanë dërguar në burgun e Kralevës, të Pozharevcit etj., ku torturat kanë qenë çnjerëzore.

Kur shkonim ta takonim shpesh e binin duke e mbajtur për krahun, nuk mund të fliste, çdo herë kishte shenja

të rrahjes në trup dhe në fytyrë".

Dhe, teksa nënë Ryla tregonte për të birin, shpesh shikimin e drejtonte në fotografinë e bijve të saj, të varur në mur, shikim të cilin e përcillte edhe me ofshama...

"Njëherë Skënderi më tha: "Nënë, shko në Prishtinë dhe mundohu t'më kthejnë ta vuaj dënimin në Prishtinë, se për Kosovë kam hy në burg!". Unë shkova në zyrën e të parit të policisë të asaj kohe në Prishtinë (emri e mbiemri i njohur për Redaksinë) dhe ia tregova hallin tim. Ai me nervozizëm më tha: "A po i sheh këto letra, të gjitha janë lutje të bëra nga ju (e kishte fjalën për lutjet e familjarëve të të burgosurve). Shko ka ke ardhur se unë asnjë send nuk bëj!".

Dola në korridor e humbur mendësh dhe papritur më doli përpara Kolë Shiroka dhe më ftoi brenda, ma bëri një kafe dhe biseduam.

Unë nuk e njihja Kolën, por qëndrimi i tij dhe biseda më lehtësuan shpirtërisht, edhe pse edhe Kola nuk më ndihmoi...", evokon të kaluarën nënë Ryla.

## RRËFIMI PËR NJERIUN IDEALIST

"Agroni ishte fjalëpakë, i kulturuar, i dashur dhe i arsyeshëm. Ai pas studimeve punoi si veterinar në Klinë, pastaj në Dragash dhe, së fundi, si mësues në Gjimnazin e Istogut dhe pasdite në ordinancën e veterinės.

Bashkëjetonte me shoqen e tij të studimeve. Papritur i erdhi thirrja që urgjentisht të shkonte në shërbimin ushtarak. Dukej se u mërzit se ishte në fazën e rregullimit të jetës dhe ndoshta kishte droje se Skënderi ishte në burg (1984). Por, në pamje dukej disi krejt normalisht, ndoshta nuk donte të na frikonte.

Së pari, e dërguan në Novi Sad, pastaj në Plevle të Malit të Zi, për të përfunduar në Bačka Topollë. Atje kishin pasur një fermë prej 1000 krahë lopësh dhe Agroni shërbente si veterinar.

Agroni është munduar të jetë shumë i kujdesshëm, por ata gradualisht kanë filluar ta maltretonin, e kanë marrë në pyetje për Skënderin etj.

Më në fund, janë përpjekur ta detyrojnë edhe ta mohonte se e kishte vëlla Skënderin!

Agroni u kishte thënë: "Unë vëlla e kam, ju bëni çfarë të doni!".

Pas shtatë muajsh erdhi në pushim për tri ditë. Neve nuk na tha gjë, edhe pse ishte i ngrysur dhe pa fije disponimi. Dajës së vet i kishte thënë: "S'di a vi më se ma kanë vu syrin, po donë me më likuidual!".

Dy ditë para se ta vrisnin fola me të në telefon dhe më tha: "Nënë, bëma qarën!". Unë u mundova ta qetësoja... Më 23 gusht 1984, në orën 23 e 10 minuta e kishin mbytur në ordinancën e "tij" ushtarake", rrëfen me ngarkesa emocionale nënë Ryva, e cila edhe përkundër mënyrave që i ranë mbi kokë, nuk u ligështua kurrë.

Në pyetjen: "Si e morët vesh vdekjen e Agronit dhe cili ishte arsyeja?", ajo thotë:

"Të nesërmen e vrasjes erdhi te ne një zyrtar i KOST-it, njëfarë Ismeti, nga Kaçaniku, dhe na tha se Agroni ka vdekur në ushtri. Një herë tha se është vetëvarur, pastaj ka pasur aksident automobilistik dhe, së fundi, ka vdekur nga gripi i derrave!

Më 25 gusht u soll kufoma në arkivol të mbyllur hermetikisht. Një kapiten i ushtrisë më thirri dhe kërkoi që të hapej arkivoli. Unë i thashë: "Jazëk u qoftë! I dërgova dy djem në shërbim ushtarak dhe njërin ma burgosët, kurse tjetrin ma kthyet në arkivol!".

Ai nuk foli...

Fshehurazi është hapur arkivoli dhe Agroni kishte dy shenja të plumbit, një në kokë dhe një në krahator. Varrimi u bë madhështor, ku morën pjesë mijëra qytetarë, edhe përkundër përpjekjeve të policisë që t'i ndalonin ata...

Pas disa muajsh me Haxhiun shkua në Gjyqin Suprem në Beograd dhe kërkua sqarim për vdekjen e Agronit. Unë kërkova analizën e "krimit". Ata i sollën fotografitë e vendit të ngjarjes, fotografi të mbushura me gënjeshtër të improvizuara dhe të pakoordinuara dhe të pakapshme për kokën e njeriut...

Dhe, kur nuk jam çmendur aty nuk çmendem më kurrë! Agroni ishte në fotografi i veshur e i mbathur dhe me litar në qafë! Thashë: "Kjo nuk përkon me realitetin! Ju e keni vra Agronin!". Njëri më tha: "Kjo është fshehtësi ushtarake".

Ndërkohë u lirua Skënderi. Ishte i dobët nga shëndeti, mushkëritë e dëmtuara, kishte probleme të mëdha

me shqisat e të dëgjuarit, probleme me kanalet urinare. Pastaj, mbetëm të izoluar dhe nuk na vinte askush, as nga farefisi! Patëm shitur tokë dhe gjithçka që patëm për ta mbrojtur Skënderin, aq sa u varfëruam shumë. Ndihamë nuk kishim nga askush... Andaj, edhe jetuam shumë keq. Ngritëm padi për Agronin, por rasti kurrë nuk u shqyrtua!", tregon këtë pjesë të rrëfimit protagonistja jonë.

## METAFORA E ËNDRRËS QË U BË REALITET

Akumulimi me vite i urrejtjes është dhembje e shumëfishtë nëse një ditë nuk mund të shprehet, aq më shumë nëse nuk realizohet premtimi që njeriu i vë vetes.

Për të gjithë ne (popullin) dhe ata (të keqtrajtuarit) UÇK-ja hapi rrugë në fillim të vitit 1998.

"Skënderi priti me pa durim të vinte ajo ditë. Që në momentin e parë iu bashkëngjiti Shtabit të fshatit dhe aty ku ishte nevoja për të kontribuar ai edhe ishte. Madje, Skënderi ka shkua edhe në Shqipëri për të sjellë armë për UÇK- në.

Më 3 prill 1999 fshati ynë u sulmua nga forcat serbe me ushtarë dhe arsenal luftarak. Ne ikëm dhe kaluam në fshatin Dashinoc. Skënderi erdhi dhe qëndroi tri ditë me ne dhe u kthye prapë në shtabin e fshatit.

Pasi dëgjua se shtëpinë na e kishin djegur forcat serbe, vendosëm të niseshim me turmën e njerëzve të asaj ane për në Shqipëri dhe me Skënderin nuk mund të takoheshim.

Dhe, kurrë prej asaj dite më nuk patëm ndonjë lajm të drejtpërdrejtë nga ai. Njerëzit që kanë qenë afër tij thonë se

ai ka qëndruar në shtab edhe 14 ditë, pastaj nuk është parë më. Është zhdukur bashkë me Ismet Ferizin, Bylbyl Ferizin, Bashkim Ferizin, pjesëtarë të shtabit të fshatit. Pas lufte u kthyem nga Shqipëria. Tre kushërinjtë e Skënderit u gjeten të vrarë në Bistricë,

e Skënderi jo. Pas pak ditësh erdhën disa zyrtarë të UNMIK-ut dhe na tre-guan se trupi i Skënderit është gjetur i vrarë dhe i varrosur nga disa romë në Çabrat të Gjakovës.

Në atë moment e di se kam mbetur pa frymë, më janë mbyllur veshët, më kanë lëshuar këmbët se më erdhën në mend fjalët e tij, vuajtjet e tij dhe tani vdekja e tij.

Por, shpejt u ndjeva e lehtësuar që Skënderi arriti atë që dëshironte, të bëhej pjesë e pavdekshme e lirisë së Kosovës", rrëfen nënë Ryva, duke qëndruar mes dy ndjenjave, dhembjes dhe krenarisë.

Dhe, pasi pushoi pak nënë Ryva, i bëra pyetjen: "Sa jeni e kënaqur me qëndrimin e pushtetarëve ndaj familjes tuaj?".

"Unë e as familja ime nuk jemi ekspozuar karshi qeveritarëve të pushtetit lokal. Prandaj, kemi mbetur të anashkaluar. Dua t'i falënderoj dy njerëz që na kanë ndihmuar të mbetemi gjallë: Lulzim Delinë (shok i Skënderit) dhe Metë Ademajn, mik i shtëpisë. I pari na ndihmoi që të kemi bukë me ngrenë dhe i dyti na e mbaroi shtëpinë në të cilën jetojmë.

Ne vuajtëm pas lufte për gjithçka dhe askush nuk e ktheu kokën kah ne.

Ende Agronit nuk i është zgjidhur statusi. Tash bëhen 29 vjet nga vrasja e tij dhe nuk bëhet fjalë për veprimtarinë e tij, as të Haxhiut, si veteran i arsimit. E, sot që po flasim për ta po më duket se janë ngjallur.

Për të jetuar po më ndihmojnë fëmijët e Skënderit: Iliri, Dardanja, Dukagjini, Agroni. Tash nuk po na sheh as pushteti e as mileti", përfundoi rrëfimin e saj nëna e dy heronjve: Skënderit e Agronit, Ryvë Ferizaj.

**Sanije Thaqi**

Radio, Lajme, Moti, Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin Shkabaj për Android

Google play

Shkabaj

www.shkabaj.net





**Mandarine Restaurant by Marina Bay**

+35533410000

+355696041000

**Lime Lounge by Marina Bay**

+355696041001

info@marinabay.al

www.marinabay.al

**Adresa:** Vlorë, Shqipëri



# Si i mbeti në duar fëmija një muajsh nënës së Ilir Shaqirit në luftë?

Në kohë të rëndë, kur njeriu s'pret më shumë se vdekjen, vetëm nëna drenicase di të bëjë solidaritet të tillë, sikur ndodhi me foshnjën tri javësh, Kaltrinën.

Në Izbicë, në furtunën e predhave artilerike të vitit 1999, nëna e Ilir Shaqirit ia mori një gruaje foshnjën binjake, që quhej Kaltrinë.

Nëna e Kaltrinës nuk mund t'i mbante të dyja në duar në fushën e granteve të ashpra të ushtrisë dhe policisë serbe.

Në atë zonë, nëna e Ilirit, me Kaltrinën tri javësh në duar, u detyrua të shkojë në një drejtim, e nëna e Kaltrinës, me binjaken tjetër, në drejtim të kundërt. Dhe, lufta i ndau për dy muaj e gjysmë dhe më nuk u panë.

Nëna e Ilirit merr përsipër kujdesin për Kaltrinën e vogël.

Dhe, duke mos pasur zgjidhje tjetër, ajo hyri në varrezat e fshatit dhe mori një tas që t'i shërbejë foshnjës për ushqim. E pastroi mirë tasin dhe i ofroi një lope në mal, teksa qëndronte me

lopët tjera, për t'i siguruar Kaltrinës qumështin.

Kështu, çdo ditë, nëna e Ilirit ia siguronte qumështin Kaltrinës...

Dhe, tek pas dy muajsh takohet me nënën e Kaltrinës. Ia dorëzon vajzën e vogël, Kaltrinën.

Pra, kthimi i Kaltrinës te nëna e vet ka ndodhur në fshatin Tushilë.

## P. S.

Nëna e Ilir Shaqirit ka vdekur më 13 qershor 2020.



# Luftëtari shqiptar i Kroacisë kthehet në Shkabaj pas 15 vjet zhdukjeje!

Bindja e të gjithë familjes në Shkabaj ishte se Mani ishte zhdukur prej vitesh. Kishin jetuar nën vitet e etheve enigmatike, nëse ishte vrarë apo nëse do ia gjenin trupin e pajetë.

Koha kur kishte dalë nga shtëpia ishte viti 1989, vite kur Serbia i vriste në vazhdimësi shqiptarët. Të gjitha portat e kërkimit të tij ishin të mbyllura, pasi në Kosovë ishte një pushtet policor antishqiptar, që kur i shkoje në derë për kësë tema, i rritej edhe më shumë zemra.

Askush nuk e dinte se ai luftonte në Kroaci. Dhjetë vjet jete pa asnjë informacion, ndërsa pas 15 vitesh është kthyer në shtëpi, pa e njohur askush...

Në tarracën e Hotelit "Grand" në Prishtinë, Abdurrahman Halili, i lindur më 1968 në fshatin Shkabaj të Kastriotit, përjetonte lirinë e Kosovës pas 15 vitesh largim nga atdheu.

Djaloshi me pamje të një burri të matur dhe të pjekur, që jeta e ka bërë të duruar dhe të guximshëm, ka luftuar në luftën e Kroacisë kundër forcave serbe.

Ka qenë në vijën e parë të frontit në shumë beteja dhe ka fjetur me pajisje në shpinë në fusha e male.

Ai llogaritej i zhdukur nga familja dhe të afërmit, pa ditur askush për të asgjë se ku ishte dhe çka bënte.

Jeta e tij, e ngjashme me personazhet e filmave të aksionit, e bën Manin edhe më të madh.

Nëse vlejnë vargjet e një poeti se "vuan për t'u argëtuar ai tjetri", kjo veçanti i takon pikërisht Abdurrahmanit, që shkurt e thërrasin Man.

Pseudonimi i tij në Kroaci ishte "Rico" (Kaçurreli). Përvoja e tij në luftëra për katër vjet e gjysmë, jeta për ekzistencë dhe ndihma që u ka dhënë shqiptarëve në shumë vende të Ballkanit, më shumë në Kroaci, e bëjnë atë me eksperiencë të lartë, të aftë ta kuptojë realen dhe syrin e njeriut, sjelljen dhe intuitën, dashurinë dhe urrejtjen e shumë veçori të tjera shoqërore.

## SI DOLI MANI NGA SHTËPIA?

Mani ka dalë nga shtëpia e tij më datën 15 dhjetor 1989, i vetëm, pa pasur adresë se ku do të shkonte e përfundonte.

21-vjeçari nga Shkabaj, në Jugosllavinë

e atëhershme, e që kishte hyrë në fazën e fundit të dezintegrimit e shpërbërjes, kishte marrë rrugën si në përrallat fantastike, që zakonisht nuk tregojnë vend, por që përfundojnë në mënyrën më të pamundshme.

Si e nisi rrugën e ku përfundoi, Mani tregon vetë:

"Me të dalë nga shtëpia, e që shkak ishte bojkotimi im për shërbim në APJ (Armata Popullore e Jugosllavisë), shkova në Zenicë, në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Atje qëndrova tre muaj. Kam jetuar për mbijetesë dhe asgjë më shumë. Nuk jam lajmëruar në shtëpi për më shumë se 10 vjet që nga dita kur dola prej shtëpisë", thotë Mani.

Dhe, rrëfimin e tij e vazhdon fqinji, Bekimi, i cili thotë se e kishin diskutuar gjatë që ta paraqitnin në polici si të zhdukur, por që nuk e kishin bërë këtë, pasi nuk donin t'i shkonin në derë policisë serbe.

Kjo kishte bërë që familja t'i qonte duart për Manin, e ky i fundit vazhdon:

"Nga Zenica shkova në Dubrovnik të Kroacisë, për të vetmen arsye të mos i shërbeja ushtrisë jugosllave, që e urreja shumë.

Ka qenë mesi i muajit mars të vitit 1990 kur shkova në Dubrovnik. Tashmë të gjitha lidhjet e mia me Kosovën ishin shkëputur, e aty fillova punën në turizëm, si kamerier.

Në Kroaci po krijoheshin rrethana shqetësuese, me që ofrohej lufta e pashmangshme, duke mos pasur asnjë zgjidhje tjetër. Kisha bindjen e plotë se do të kyçem në luftë kundër forcave serbe, pavarësisht pasojave që mund t'i kisha.

Vendosa të bëhesha luftëtar për ideale të Kroacisë, por duke pasur në mendje se liria e çdo populli më takonte edhe mua", thotë ai për fillimin e luftës në Kroaci.

## PJESËMARRJA NË LUFTË

Ka qenë data 15 shtator 1990, data kur Mani ishte inkadruar në armatën e Kroacisë, së cilës iu imponua lufta.

"Ushtrova fillimisht tre muaj", thotë Mani dhe shton:

"Të gjitha ushtrimet ushtarake i kreu në malet shkëmbore në Dalmacisë dhe prej aty u kyça në luftime në Kroacinë e Jugut, vend rreth Krainës.

Katër vjet e gjysmë kam luftuar dhe kam



njohur më shumë se 150 ushtarë shqiptarë, por ka pasur edhe qindra të tjerë që nuk kam arritur t'i njihja, edhe pse luftonin, por kishin detyra të ndryshme...

Shifra kroate për pjesëmarrjen e luftëtarëve shqiptarë në çlirimin e Kroacisë kundër serbëve ishte sekrete dhe ka gjasa të mos bëhet publike kurrë.

Ajo që dihet është se ne, si luftëtarë shqiptarë, kemi qenë shumë të çmuar e vlerësuar nga kroatët, si nga populli, po ashtu edhe nga armata.

Kishte shumë arsye pse gjërat qëndronin kështu: Kroatët e dinin se ne ishim besnikë në luftë dhe se luftonim kundër të njëjtit armik.

E, tjetra, më e rëndësishmja, se kishim hyrë në luftë vullnetarisht, për çka ishim të çmuar dyfish më shumë.

Kroatët e dinin se ishim ne, shqiptarët, të parët në Jugosllavi që e bojkotuam ushtrinë jugosllave. Pseudonimi im në luftë

ishte "Rico" (Kaçurreli) dhe me këtë nofkë më njihnin gjatë gjithë kohës së luftimeve. Por, edhe dosjet e luftëtarëve në Kroaci krijoheshin sipas nofkave që ishte parim... Nofka ime në Kroaci u bë shumë shpejt e njohur në tërë frontin e më gjerë, edhe pse, mund të them, nuk ka pasur ushtar shqiptar të dobët në luftën e Kroacisë, ashtu qysh nuk ka pasur luftëtarë shqiptarë të papërgatitur dhe me mungesë guximi për aksione frontale.

Kontributi shqiptar në Kroaci ka qenë shumë i madh, por të luftosh ka pasur kushte. Armatim kishte me bollëk, ushqim e veshmbathje gjithashtu.

I kam dëgjuar shumë herë kroatët duke thënë se shqiptarët janë luftëtarë të etur kundër Serbisë dhe se ata na trajtonin me respekt si besnikë, pasi që e kishim të njëjtin armik.

Unë i demantova në një rast, duke u thënë se nuk është kjo e saktë, sepse kur shqiptarët kanë luftuar në Spanjë nuk e kanë pasur të njëjtin armik me spanjollët, por shqiptarët janë nga natyra luftëtarë të mëdhenj dhe nuk koriten kur hyjnë në lufta të drejta.

U thashë se shqiptarët janë liridashës për të gjithë popujt që u mungon liria... E, tek atëherë ata bindeshin se shqiptarët ishin të tillë dhe çmonin lirinë kudo që duhej të ishte ajo", tregon Mani.

## LUFTUAN VULLNETARISHT, E PASLUFTE SËRISH NJERËZ PA BUKË!

Vlugu i luftimeve në Kroaci ishte i gjatë dhe i mundimshëm.

Mani, meqë nuk dëshiron të përgjithësojë asgjë, kishte marrë detyra speciale...

"Ne kemi hyrë në luftë vullnetarisht, s'kemi pasur prej askujt asnjë leverdi! Synimi im ka qenë të bëhem luftëtar me fyturë. Nëse vritem - të vritem me moral lufte sikur e meritoni", thotë Mani dhe nënvizon: "Ky ka qenë fitimi ynë më i madhi - ta mposhtim Serbinë në front! E kishim edhe përkrahjen e liderëve tanë që vinin në Kroaci: Atëbotë na kanë vizituar: T. B., B. S., A. R. etj.

E, ndoshta nuk është korrekte të flas me emra, edhe pse dihen botërisht...

Fillimi i luftës më 1991-1992 ka qenë shumë i vështirë. Kemi luftuar gjoks për gjoks me forcat çetnike nga Serbia, paramilitarët, ushtarët e rregullt dhe serbët vendorë të Kroacisë.

Në frontin e luftimeve, në vendin e quajtur "Velika Glava", kemi zhvilluar luftime në distancë 70 metrash. Luftime të rrepta kemi zhvilluar në Bicina, Dubrovnik, Zhitnik, Papovo Pole, Debeli Breg etj.

Ka qenë edhe fronti tjetër i luftimeve, bashkë me luftimet të "Ura e Moslinës", ku mora pjesë në luftën e çlirimit të urës

në hyrje të Zarës, pastaj në Zemunikon e Poshtëm dhe të Epërm.

Po i përmendi këto pak vende të luftimeve për të ardhur te tregimi se hymë në zemër të Kroacisë për ta çliruar atë...

Luftuam, por s'mund të mos them qysh tash se pas luftës u injoruam ne, luftëtarët shqiptarë nga shteti, institucionet dhe populli.

Duke e parë këtë gjendje, secili shqiptar ka mbetur duke e pyetur veten: Pse luftova për Kroacinë?

Çka m'u ndesh liria e kroatëve dhe pse t'ua sjell unë, shqiptari i Kosovës, atyre lirinë? Nuk ishte kjo me rëndësi, tek e fundit, se ne kapëm armët dhe luftuam kundër Serbisë, por nuk mund të pajtoheshim me injorimin që na bënë dhe për nënçmimin, ndërkohë që kishim luftuar aq burrërisht dhe më shumë se vetë kroatët për vendin e vet...

Kisha bartur në shpinë armë automatische dhe snajperë. Kam qenë snajperist i përkryer dhe besnik në sulm e në mbrojtje.

Kam qenë i pathyeshëm dhe kam zhvilluar të gjitha llojet e luftërave. Kam qenë diversant, frontalist dhe luftëtar i pathyeshëm në mbrojtje.

Kemi bërë luftë të pastër e kurrë nuk kemi kryer krime. Sepse, luftëtarët e vërtetë nuk bëjnë krime në masën e pambrojtur dhe civile që nuk është në luftë...

Krimet janë kryer në brendësi të Kroacisë nga serbët, kur ata kapnin ndonjë kroat.

Mbaj mend rrezikun në Dubovicë, kur më ka rënë dy metra afër predha e rëndë dhe kam shpëtuar, ndonëse shumë të tjerë kanë pësuar.

Më ka ndodhur tri herë të më vriten shokët e njësitit para këmbëve, por kam pasur fat gjithmonë.

Mendoja se nëse vritem dikush nga shokët do të ma kumtonte publikisht vrasjen dhe vdekjen, duke e informuar familjen time, që të dihej, të paktën, se kisha mbetur i vrarë në luftën e Kroacisë për çlirimin e saj.

Në luftimet e Milevcit më ka ndodhur ta humbi lidhjen me komandën. Dhe, kur lidhja bie prej sistemit, komandanti më nuk është komandant.

Tri ditë kemi qëndruar brenda territorit serb, duke kryer aksione diversante, pa pasur lidhje me komandën dhe arritëm të shpëtonim nga çetnikët.

Pas tri ditësh arritëm të lidheshim me shtabin dhe komandën. Komanda e shtabit tonë kishte menduar se ne ishim vrarë e zhdukur, ashtu sikur mendonin në shtëpi se unë isha zhdukur e tretur nga kjo botë...

Gjatë asaj kohe çdo vendim dhe veprim e ndërmorëm vetë dhe arritëm të ktheheshim në bazë fitimtarë dhe të gjallë.

## NË LUFTËN E KROACISË

## SHQIPTARËT E PËRFAQËSONIN KOMBIN TONË

Abdurrahman Halili (Mani), i trajtuar nga familja si i zhdukur, e me të cilin familja kishte humbur çdo kontakt, nëse nuk e merrte vendimin për kthim në shtëpi për dy ditë, ai më kurrë nuk do të kthehej. Ishte mësuar me luftën dhe me shokët në front e në jetën e luftës...

Rrëfimi i Manit për një ndjesi ndryshe nga ajo e të jetuarit në shtëpi, tashmë ishte zëvendësuar me respektin e të tjerëve ndaj tij.

Ai e tregon arsyen pse ishte bërë njeri i respektuar:

"Luftëtari çdo kund është i shenjtë, por në Kroaci besoj se më shumë se çdo kund tjetër ishte i tillë.

Në luftë për jetë a vdekje, kishte kuptim vetëm një gjë: Kroacia duhej ta fitonte lirinë, ta fitonte betejën nga Serbia, e cila e kishte vënë në dispozicion të vetin arsenalin luftarak të Armatës Popullore të Jugosllavisë.

E, kur je në pozicion ku ka kuptim vetëm liria dhe fitorja, luftëtari është i shenjtë", thotë Mani dhe vazhdon:

"Ne, luftëtarët shqiptarë në luftën e Kroacisë, nuk ishim, thjesht, vetëm luftëtarë, por ne e përfaqësonim kombin tonë, në përgjithësi.

Dhe, duke qenë të disiplinuar e trima, duke qenë komunikativë e të shkathët në luftë, ne përfaqësonim shumë më shumë se vetveten.

Kroatët befasoheshin nga trimëria jonë në front. Kroatët thoshin shpesh se nëse te ju në Kosovë do të kishte luftë me Serbinë, shqiptarët do ta fitonin shpejt lirinë...

Shqiptarët në Kroaci kanë qenë shembull si luftohet në front. Unë, që di mjaft për luftën në Kroaci, e di se Dalmacia ishte e ndarë dhe luftohej dhëmb për dhëmbë të mos mbetej e tillë.

Nëse dikush më pyet se ku ndihem më mirë, them me plot gojë se unë kam qenë më i kënaqur në luftë sesa në liri, edhe pse luftën e bënim për lirinë e të tjerëve.

Kur jemi këtu, mund të bëjmë një krahasim se pas luftës ndryshuan gjërat shpejt. Nuk di nëse është kështu në të gjitha luftërat, por në Kroaci njerëzit të mirat na i harruan shpejt!

Nëse i thua dikujt se kam luftuar për lirinë e vendit tënd, ai të thotë se vetë ke dashur!

Pra, asgjë e jashtëzakonshme edhe nëse vdes, edhe nëse lë familjen!

Dhe, vepra ime në këtë rast do të përfundonte me një guri te koka, në të cilin do të shkruhej "Varri i vullnetarit".

Kur i thua dikujt vullnetar në luftë, nuk qon shumë peshë, sepse të llogaritin sikur ke hyrë në luftë duke mos e dashur jetën që e jetoje deri atë ditë.



E keqja e pasluftës në Kroaci, për një luftëtar shqiptar, është se askush nuk mban evidencë a ke familje apo nuk ke, qoftë nëse je vrarë në luftë, qoftë nëse e ke mbijetuar luftën.

Edhe pas luftës në Kroaci jeta ime ka vazhduar për ekzistencë, thjesht, një jetë shqiptari...

Nga ajo që di unë, vetëm dy shqiptarë kanë marrë banesa. Ka marrë banesë oficeri i lartë i Ushtrisë Kroate, Rrahim Ademi, që ishte ekstraduar në Hagë për krime, çka nuk është absolutisht e vërtetë.

Kur jemi këtu, po e shfrytëzoj rastin t'i them opinionit se vetë Franjo Tugjmani e ka futur në listën e të kërkuarve për krime, sa për t'i mbuluar krimet e oficerëve të tjerë!

Kështu ishte edhe me oficerin Ademi, kur lufton për ushtri të huaj! Në fund del dikush e të kapë për veshi për të ta hedhur fajin e vet", tregon Mani.

## FRONTI I LUFTIMEVE DERI NË BOSNJË E HERCEGOVINË

Kroacia, sipas Manit, kishte ambicie të pushtimit të Bosnjë-Hercegovinës, ashtu sikur kishte pasur ambicie edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ishte një ide e politikës kroate, në krye të së cilës qëndronte Franjo Tugjman me oficerët e vet.

Aq më shumë kur dihej se pas Kroacisë radhën e kishte Bosnjë-Hercegovina.

Ishte e pashmangshme lufta e radhës, për të cilën veç bëheshin plane në Serbi dhe për të cilën agjencitë e huaja të zbulimit e kundërzbulimit flisnin çdo ditë publikisht. Abdurrahman Halili (Mani) e kishte prouar në terren një gjë të tillë personalisht dhe, lidhur me këtë, deklaroi:

"Gjatë luftës në Kroaci unë u futa në frontin e luftimeve deri në Bosnjë e Hercegovinë, sepse kroatët thoshin: "Mos e lëkundni Murin në Berlin se kroatët e ndërtojnë në Drin!". Kjo ishte parulla kroate për okupim klasik të Bosnjës e Hercegovinës", tregon Mani dhe nxjerr detaje:

"Vazhdimësia e okupimit varej nëse vazhdonte lufta në Bosnjë e Hercegovinë menjëherë dhe nëse bashkësia ndërkombëtare nuk do ta përkrahte ekzistimin e Republikës së Bosnjës e Hercegovinës që do të bëhej shtet në vete, në një proces të shthurjes së Jugosllavisë.

Ëndrrat kroate për okupimin e Bosnjës e Hercegovinës ishin të pranishme, megjithatë gjërat u zhvilluan ndryshe. E, tash, ajo çka më takon mua ta them është se nga lufta në Kroaci unë, si shumica e shqiptarëve që luftuan atje, kanë përfituar dy gjëra:

Mua m'i kanë njohur meritat e luftës, si dhe nënshpëtimin në Kroaci nga viti 2004.

E, këto janë tepër pak, krahasuar me jetën që e kishim vënë në vdekje. Por, përsëri, kur kthehem në kohë dhe mendoj se si në front e kisha vetëm një dëshirë, ashtu sikur e ka çdo luftëtar në luftë të huaj: Ta fitoja luftën dhe nëse vritesha në luftë ta kisha një shenjë për të mos më humbur eshtrat dhe varri.

Unë, si luftëtar në luftën e Kroacisë, këtë të dytën mund ta bëja. Por, nëse do të qoja fjalë në shtëpi, familja mund të kishte pasoja të rënda...

Kur je në front të luftimeve, rriten ndjenjat për familjen dhe e tëra që e ushqen atë ndjenjë është që nëse vritesh të mbetet një shenjë që dëshmon se ke luftuar dhe ke ekzistuar dikur...", thotë Mani.

## SI E KUPTOI FAMILJA SE MANI ISHTE GJALLË?

Më shumë se 10 vjet askush në familjen Halili nuk ka ditur se Mani është gjallë!

Mani është paraqitur në telefon te halla për herë të parë pas më shumë se një dekadë, në kohën kur më askush për të nuk fliste e nuk kishte as shpresën më të vogël se ishte në jetë...

Dhe, duke treguar detajet, Mani tregon se si e bëri të ditur se ishte në jetë:

"Ka qenë numri i vetëm telefonik i hallës ai që kam mbajtur në mend. Dhe, vendosa ta telefonoja hallën. Telefonova dhe prita kush do lajmërohej. Kur i tregova se isha unë, halla nuk mundi të thoshte asnjë fjalë...

Mund të mos i jem kujtuar pas aq kohe, apo...

Pasi i tregova për së dyti se kush jam, halla përsëri më pyeti: "Kush është në telefon?". "Jam Mani", i thashë.

Hallës, si duket, i ra të fikët...

U krijua rrëmujë në shtëpi...

Vajza e hallës e mori telefonin për të pyetur se kush ishte në telefon dhe çka ndodhi...

"Kush je ti?", pyeti vajza e hallës.

I thashë edhe asaj njëjtë...

Ajo, nga lajmi i befasishëm që nuk e priste, përjetoi fatin e njëjtë si halla...

E kuptova nga zhurma që ndodhte, sepse

të gjithë përjetonin diçka mes gëzimit e lotëve...

Pastaj, është paraqitur në telefon edhe vajza e dytë e hallës. Por, ajo disi u përmbyt... I thashë – jam Mani që jam i zhdukur që 10 vjet...

Më tha - kë e ke babë? Kë e ke nënë? Sa vëllezër e motra ke?", tregon Mani.

## KTHIMI NË SHTËPI PA E DITUR ASKUSH!

Duke e përshkruar kthimin në shtëpi, Mani tregon se as ai vetë nuk e dinte ditën kur do të kthehej.

"Askush nuk ka ditur se kur do të kthehesha në shtëpi", thotë Mani për të vazhduar:

"As unë vetë nuk e kam ditur se kur do të kthehesha! Kam pasur shumë dilema - të kthehesha apo jo. Dhe, më besoni, se po të mos kisha vendosur të kthehesha gjatë atyre ditëve, më kurrë s'do ta kisha parë Kosovën...

Kur erdha në shtëpi, u futa në oborr.

Asgjë nuk kisha harruar. Vëllai, Ismaili, më shikonte si një i huaj...

Hapa derën e shtëpisë, e ai u ngritë sikur deshi të më thotë se nuk hyhet në shtëpi të huaj në këtë mënyrë... Por, mënyra si po i afrohesha shtëpisë aq i vendosur, atij nuk i ofronte asnjë mundësi të thoshte diçka më shumë...

U shikua bukuri gjatë në oborr! Pas një kohe më pyeti:

"Mos je Mani?".

"Mani jam", i thashë.

U përqaftua gjatë, pa thënë asgjë tjetër... Ishte befasi dhe dhimbje, njëkohësisht...

Erdhi, pastaj, vëllai i madh dhe njëjtë u njoha edhe me të...

Pastaj, kuptova se babai dhe të tjerët kishin qëlluar në një dasmë. Më thanë t'i thërrisnin, por nuk lejova të shkëputeshin nga dasma, edhe pse ardhja ime në këtë mënyrë ishte më e madhe se çdo dasmë tjetër...

Të nesërmen në shtëpi erdhën dhe të tjerët dhe kuptuan se unë isha kthyer...

Ishte e rëndë, sepse lotët dhe gëzimi u bënë bashkë...", thotë Mani.

**Safet Krivaça**

DIKUR...



# Ç'farë dobësish kishin dikur të famshmit e tashëm?

## NAIM KRASNIQIT I DRIDHESHIN KËMBËT NË SKENË!

Prezantimi i parë në skenë i Naim Krasniqit, pa dyshim, ishte mbresëlënëse, edhe pse atëherë, ndoshta, nuk ishte aq i vetëdijshëm se ai do të jetë një moment shumë i rëndësishëm për karrierën e tij.

“Çdo gjë që bëhet për herë të parë në jetë është me rëndësi të veçantë dhe njeriu e përjeton me emocione.

Për mua prezantimi skenik e ka një rëndësi shumë të madhe, një vlerë të posaçme.

Unë kam pasur përvojë për prezantim skenik, jo si solist, por si këngëtar i grupit të shkollës së mesme.

Prezantimi im i parë ka qenë në Festivalin “Kënga e rinisë” në vitin 1982.

Në atë festival jam prezantuar me disa këngë: interpret, kompozitor, orkestrues.

Atëherë ishte përgjegjësi e madhe se këndohej “live” me orkestrën e madhe të Radio Prishtinës.

Më kujtohet strofa e parë e këngës. Gjatë tërës strofës jam koncentruar që të ndali dridhjen e këmbëve nga emocionet...

Natyrisht, dridhjet nuk i kanë vërejtur të tjerët, por i kam përjetuar unë...

Sidoqoftë, ishte prezantim i suksesshëm, pastaj u hapën dyert për suksese të vazhdueshme”, thotë para shumë kohësh Naim Krasniqi.



## ALKETA VEJSIU NUK I DONTË PRINDËRIT E VET NË SPEKTAKLET E SAJ!

Në fillim të karrierës së Alketës, prindërit e saj kishin shkuar të përcillnin spektaklin e saj. Por, ajo, kur merr vesh se ata janë në sallë, nuk del në skenë dhe fillon të qajë.

“Kjo ishte një dobësi që e kam pasur dikur. Tash jam mësuar, sepse prindërit e mi kanë një domethënie shumë të madhe për mua.

Dikur prania e tyre më dekoncentronte dhe më krijonte një emocion të jashtëzakonshëm, sepse unë gjithë suksesin ua dedikoja atyre.

Patën ardhur për herë të parë mami dhe babi në spektaklin që e udhëhiqja. Isha shumë e stresuar dhe, vërtet, kam filluar të qaj.

Por, ata më kuptuan dhe gjetën një vend paksa më të fshehtë dhe më nuk i pashë”, pat thënë Alketa me një rast.







# Si u bëra hajn, e pastaj njeri?

*Biseda me "Personin X" është autentike. Një mafioz i paraluftës që merrej me hajni. Kishte bashkëpunuar me policinë serbe, por edhe ishte ruajtur prej tyre...*

Personazhi i rrëfimit ka kaluar nëpër disa faza të veprimtarisë së tij. Nuk është arrestuar ndonjëherë dhe i ka takuar rrjetit të hajnisë, që ishte organizuar nga grupe që nga Prishtina e deri në Mitrovicë, ku ai thotë se ishte çerdhe e hajnisë së veturave dhe gjërave me vlerë, që sigurohej dhe menaxhohej nga policia serbe. "Personi X" sot është me autoritet, inteligjent dhe i matur! Ai pranon se gjërat që i ka bërë, u përkasin njerëzve që nuk janë në tokën e bukës...

## SI E BËRI SEFTE?

Duke rikujtuar gjendjen familjare të skamjes, ai e përshkruan fillimin e punës së vet në veprat mafioze dhe thotë: "Kam qenë 17 vjeç kur kam filluar të merrem me hajni. Nuk e kam dashur atë zanat kurrë në jetë dhe askush në familjen tonë nuk është marrë me atë punë, e as që

merret sot. Ishte e rastit. Erdhi si shprehje e skamjes në familje. Ishim 17 anëtarë të familjes e nuk kishim as bukë në shtëpi. Një ditë dola në qytet me duar në xhepa. Një zonjë në treg numëronte paratë derisa blinte zarzavate në treg. Nuk ishin shumë ato që dukeshin në kuletë, por ishin të mjaftueshme që ta kalonim e gjithë familja ime një javë me gjëra elementare. Më edhe ideja t'ia marrë çantën. Në moment ia rrëmbeva nga dora dhe ika aq shpejt sa nuk do t'më zinte as plumbi i pushkës, siç thotë populli. Shpejt e shpejt hyra në oborrin e një shtëpie të vjetër. I zoti i shtëpisë më kapi për krahu e më ndali me dhunë. I thashë - po më ndjekë policia serbe. E, ai më tha - ikë andej...

Dola në rrugicën tjetër. Zonja nuk mundi t'më ndiqte, e të tjerët as që provonin... Nga larg dëgjoja fjalët: Hajni, hajni! Dhe, ai rast, pra vjedhja e çantës së asaj zonje, e që ishte vjedhja ime e parë, nuk më hiqet kurrë nga mendja... Më duket si dashuria e parë, por për të keq! E, sot, po ta dija kush është ajo zonjë që ia vodha çantën, do ia ktheja disa fish më shumë, duke i kërkuar falje. Por, aty e pashë sa vështirë ishte të "fitohet" paraja nga vjedhja. Po t'më zinin do mbetesha i pafytyrë gjithë jetën! Dhe, kur arrita në shitoren më të afërt të shtëpisë, hyra në të dhe bleva gjëra për shtëpi. Madje, për disa ditë i hoqa gjërat elementare... Babai më pyeti ku i kisha marrë paratë. E gënjeva se m'i dha shoku, te i cili kisha punuar herë pas herë disa ditë në



lokalin e tij.

E, hajni, njëkohësisht, është edhe gënjeshtar i shkathtë dhe këto dy gjëra gjithmonë janë të lidhura si mishi e thoni. Pra, arma më e fortë e një hajni është rrena! Sepse, kur dërgon gjëra në shtëpi duhet të gjesh mënyrën si me i "arsyetuar"! Sidoqoftë, hajnia është zanat për të cilin, së pari, duhet pasur aftësi psiko-fizike dhe gatishmëri të luftosh me njerëzit, për t'u shmangur nga dora e tyre".

## RASTI I DYTË: HAJNI ËSHTË EDHE PSIKOLOG!

Duke hyrë në pusin e ndotur të jetës, "Personi X" tregon për hajninë e dytë, e tutje...

"Hajninë e dytë e bëra në stacionin e autobusëve, kur po shkonin njerëzit në Gjermani. Ishte verë. Erdhën tre autobusë dhe u stacionuan. Ishte një tollovi, sepse, veç atyre që udhëtonin, kishte edhe shumë familjarë që i përcillnin...

E, teksa i shikoja se si pështilleshin, duhej përcaktuar viktimën, sepse hajni, njëkohësisht, është edhe psikolog i mirë.

Dhe, më ra në sy një vajzë e re, që mbante një çantë të vogël në krah. E merrja me mend se kishte para. Nuk mund të kishte shumë, sepse ishte e re, por sa për "idare" po...

Vendosa t'ia merrja çantën...

E shikova terrenin përreth mos ka ndonjë polic dhe kah duhej të ikja kur t'ia rrëmbeja çantën.

Dhe, kur ajo u përkulë ta merrte valixhen, unë ia rrëmbeva çantën nga krah dhe u nisa në drejtim të Fushë-Kosovës. Ajo filloi t'më ndjekë, por turma ishte e madhe dhe përbirova nëpër njerëz si rrëfeja... Këtë herë vjedhjen e bëra me notën pesë! Nuk kishte pasur shumë para në çantë, por për atë kohë ishin mjaft...

Këtë herë vendosa të mos blija asgjë për shtëpi, e paratë e vjedhura t'i ruaja dhe mendoja ta përfundoja me aq atë zanat. Sepse, më brente ndërgjegjja që u shkaktoja vuajtje njerëzve për atë që ishte e tyre, e më nuk ishte...

Dhe, për dallim nga hajnat tjerë, unë isha vetëm dhe atë që e vidhja e harxhoja vetë, e nuk kisha nevojë të ndaja me askënd asgjë.

Ishte punë individuale dhe jo ekipore, sepse kishte raste kur hajnat punonin në grup, ata mbronin shokun e vet nga të tjerët, duke i bërë sikur po e kapnin, po e sulmonin...

Ka pasur raste që e kanë kapur hajnin, e ata kanë qenë shokët e tij... Kanë nisur të kacafyten ndërmjet veti, sa për sy e faqe... Sepse, për të vjedhur shumë duhet punë ekipore dhe strategji e plan, por edhe më shumë përgjegjësi.

Unë isha i vetëm, andaj sado pak që vidhja edhe më mjaftonte...

## SI NDODHI RASTI I TRETË?

Rasti i tretë ka qenë në oborrin e spital-eve. Për mua më nuk ka qenë me rëndësi ku po vjedh. Nuk kishte më rëndësi ana shpirtërore! Bie fjala, po të hasja në ndonjë biznesmen të madh, do e vidhja pa mëshirë...

Dhe, pas disa vjedhjeve që i bëra me vetiniciativë, duke mos e pasur askënd rreth vetes, vazhdova të dalë në disa vende publike, ku udhëtarët prisnin të hipin në autobusë.

I thosha vetes - Ku shkojnë këta njerëz?

Sepse, hajnit i bie në mend gjithçka...

Më pas mësova se banda e caktuar e ka një territor në të cilin nuk guxon të ndërhyjë personi i bandës tjetër. Diçka si te ujqërit në mal... Ata që e dominojnë atë terren, e mbrojnë me jetë e gjak.

E, unë u bëra parashutist në këtë zanat, sepse mësova se bandat i kanë të ndarë terrenet.

Dhe, duke qëndruar nëpër stacione lokale, e në vende të caktuara, ku mendoja se ishte gjahu i ditës, kuptova se ata që dukeshin si njerëz të përhershëm, ishin personat e bandave që dilnin për të "gjuajtur", njëjtë si unë.

Ishte kohë e përshtatshme për gjëra të tilla, sepse njerëzit tanë rrallë shkonin në policinë serbe t'i paraqisnin rastet.

E, edhe kur shkonin, policia nuk merrej shumë me ta...

Sepse, nëse e zinin hajnin, ata i kërkon para. E, hajni kishte para t'u jepte, meqë i kishte fituar pa djersë...

Policia e asaj kohe, e që është çelësi i problemit, ishin hajdutë dhe kriminelë dhe ata gjithnjë gjenin hapësirë për bashkëpunim me dilerët dhe hajnat.

Një mbrëmje të vonë, me t'u errur, dy vetë më shikonin me kureshtje, sa ma futën frikën në palcë. Nuk dija nëse më shikonin pse u dukesha viktimë, apo çka tjetër?

Njëri prej tyre m'u ofrua dhe më tha:

"Çka pret ti në këtë kohë këtu?!"

"Po pres të shkoj diku, nëse më vjen një shok", ia ktheva.

Dhe, pas katër ditësh, në një stacion tjetër, i njëjti person ndaloi veturën para meje dhe e nxori kokën nga dritarja. Më tha: "Eja pimë kafë!"

Dhe, nuk prita lutje. Shkova me të, sepse ai i ra shkurt ofertës sime...

## SI U FUTA NË GRUPIN E BANDËS?

Protagonisti i këtij shkrimi, pastaj tregon për ofertën që i bënë të futej në bandë. Rrëfimi vazhdon me paraqitjen e detajeve të tjera:

"Oferta ishte të bëhesha pjesë e bandës.

Ndryshe nuk mund të mbijetoja. Ose të

futesha me ta, ose në këtë pjesë qyteti më nuk kisha çka të kërkoja...

Oferta filloi me fjalën "klepsi", që në greq-ishte ishte vjedhje.

Sepse, ata që kishin punuar me banda dhe për banda, e dinin këtë fjalë. Kur ata e thoshin këtë fjalë dhe t'i ua ktheje, e dinin se ti je hajni i shkolluar dhe pjesë e bandave...

Hymë në një lokal te "Qafa". Njëri më tha se hajnia sjell shumë rreziqe. Sepse, njerëzit që e humbin pasurinë nga hajnat, dinë edhe të të vrasin.

Ata flisnin se nuk e di me kë ke punë... E, kur i ke me vete shokët e ke lehtë: Ti për ata, e ata për ty...

Por, mua më interesonin kushtet e punës nëse futesha në bandë.

E, kushtet ishin: Vjedhjen ia dorëzon shefit.

E, ai ty ta jep pjesën me marrëveshje...

Dhe, thënë të drejtën, një gjë e tillë nuk më pëlqeu, andaj edhe vendosa të mos bëhesha pjesë e asnjë bande, por të "punoja" për vete aq sa kisha mundësi...", thotë ai.

## SI IKËN HAJNAT E MËDHENJ NË EVROPË?

Me kalimin e kohës, kur u hap rruga e ekzilit në vendet e BE-së, edhe hajnat e mëdhenj nisen të dalin jashtë Kosovës. Rreth këtij "eksodi", ai thotë:

"Kur u hap rruga për ekzil masiv, hajnat e mëdhenj dolën jashtë Kosovës. Ata, së pari, shkuan në Çeki. Atje u ndihmuan nga serbët që të dilnin në Gjermani dhe atje përfituan edhe më shumë sesa në Kosovë. Fatin e një të tilli e kam pasur edhe unë. Ka qenë interesant fakti se kur kam arritur në kufi të Çekisë, jemi detyruar të ndalemi të gjithë që nuk kemi pasur viza. Dhe, me t'u ndalur autobusi, njoha tre shokë nga Prishtina.

Pra, që të tre ishin me të njëjtin "profesion" si unë...

Dhe, me të shkuar në Gjermani, mendja përsëri më rrinte te vjedhja.

Së pari, fillova të vidhja ushqim e veshmbathje, sepse ato më mungonin... Dhe, nuk ishin gjëra të rënda ato që i merrja, por ishin përsëri diçka që ma nxisnin kureshtjen për ta theluar zanatin.

Dhe, një mbrëmje, teksa rrija me disa të afërm të dajallarëve të mi, njëri, si për çudi, më tha: "Këtu hajnat përfundojnë shpejt në burg!"

Kjo më sinjalizoi diçka të madhe. Ai sikur dinte se me çka merresha unë...

Kur u ktheva në banesë, u betova në kokë të babait e të nënës se më nuk do vjedh, madje as një gozhdë, siç thuhet në popull. U betova se do të kërkoja punë dhe do ta rifilloj jetën nga e para...", përfundon rrëfimin e tij të jetës, "Personi X".

S. M.

tourist  
**CAMPING**



Adresa: Shtoj, Ulqin    [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)    Tel: +38269336233    [/touristcamping\\_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



**Giovanni's Beach**  
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin    [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)    Tel: +38269825858    [/giovannis\\_beach\\_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)





MORINA PALACE



**Adresa:** Dhërmi, Shqipëri; **Reservation:** [info@morinapalace.com](mailto:info@morinapalace.com); **Tel:** +355 68 809 9999

 [/hotelmorinapalace](https://www.instagram.com/hotelmorinapalace)

# Me emër të Zotit, Fifi së shpejti martohet!



*Këngëtarja jonë e njohur, Fifi, si duket, së shpejti do të martohet me partnerin e saj, Adis Patushin.*

Fifi e Adis Patushi po mendojnë të hedhin një hap të rëndësishëm, siç është martesë. Edhe pse nuk kanë ende një vit bashkë, Fifi është shprehur se e ka gjetur, më në fund, dashurinë e vërtetë dhe është më e

lumtur se kurrë më parë.

Këngëtarja i ka bërë një thirrje publike këngëtarit të njohur, Labinot Tahirit:

“Kur të martohem, vëlla, dua t’me këndosh në dasmë!”, thotë ajo.

Gjatë një interviste Fifi u shpreh se, kur njohu Adisin, e kuptoi çfarë ishte dashuria dhe se vetëm tani i ka bërë zemra “bam” për herë të parë.

“Kohëve të fundit kam filluar të shkruaj këngë me përjetimet e mia, por përsëri të hiperbolizuara, deri te kënga “Diell”, që është një këngë e shkruar me ndjesitë momentale.

Kur e kam shkruar këngën “Diell” jam ndjerë e humbur totalisht. Më dukej vetja që nuk kishte botë tjetër përveç atyre mureve.

E dyta këngë, e që jam qind për qind vetja, është “Hana”, që është një përjetim i pa hiperbolizuar.

Deri te Adisi kam menduar se kam dashur, por nuk e dija çfarë ishte dashuria. Tani e kam kuptuar çfarë është dashuria. Tani nuk di çfarë të them. Kjo është dashuria, mos të dish çfarë të thuash”, thotë ajo.



# BOOM

*VIP-at tanë  
zgjedhin Greqinë  
për pushim veror*

*Milot Rashica,  
baba i lumtur  
dhe krenar*

*Çka i dhuron vetes  
Kaltrina Ajeti*

*Vajza e mixhës  
Ramë, kopje  
e Alba Morinës*

Si i mëson

*Valentina Kryeziu*

gratë të lindin përmes hipnozës  
dhe si i ndihmon njerëzit në  
aspektin fizik, mendor, emocional

*Elita Rudi  
i ka dy fjalë  
për vjehrrën e vet*

# Si i mëson Valentina Kryeziu

*gratë të lindin përmes hipnozës dhe si i ndihmon njerëzit në aspektin fizik, mendor, emocional?*

Valentina Kryeziu është shqiptarja që jeton dhe vepron në Aragau të Zvicrës, është coach dhe hipnoterapiste. Po ashtu, jep kurse për përgatitje të lindjes në nivel emocional, mental, fizik dhe spiritual përmes metodës Hipnobirthing, që do të thotë lindje përmes hipnozës.

Valentina Kryeziu aktualisht punon në ordinancën e saj në Spreitenbach të Aargaut, por edhe online. Përmes punës së saj ajo i ndihmon klientët të transformojnë bllokadat emocionale dhe për të rikujtuar resurset që ka çdo njeri në brendësinë e vet, në mënyrë individuale. Është grua e fortë, që udhëhiqet në jetën e saj nga dashuria, energjia dhe entuziazmi. Ka potencial të bëjë mirë, t'u ndihmojë njerëzve të dalin nga guaska e tyre dhe të hapërojnë në realizimin e vetvetes. Kjo është Valentina Kryeziu, me të cilin njiheni më mirë në "Boom"...





**Valentinë, nëse kërkohet ta përshkruash veten tënde, si do e bëje?**

- Jam nënë, bashkëshorte e përkushtuar dhe e dua jetën. Besoj në potencialin tim dhe jam empatike, entuziaste dhe kurioze.

**Tashmë ju dhe puna juaj janë shumë të njohura. Si ndiheni?**

- Ndihem e nderuar t'i inkurajoj gratë shtatzëna ta përjetojnë veten sovran gjatë lindjes së fëmijës.

**Për ata që mund t'u ketë shpëtuar informacioni për ty, a mund ta përshkruani me pak fjalë atë që bëni?**

- Ju ndihmoj grave shtatzëna që përmes përgatitjes të lindin pa frikë, por me plot vetëbesim dhe dituri ta menaxhojnë situatën.

Po ashtu, jap seanca për zhvillim personal.

**Sa është rritur numri i femrave që lindin përmes metodës suaj?**

- Numri po shkon vazhdimisht duke u rritur dhe po shoh se ka shumë femra të interesuara për përgatitjen për lindje përmes kësaj metode efikase.

**Me pak fjalë, na e përmbledhë lindjen përmes hipnozës?**

- Pjesa e hipnozës e bën gruan që të ndjej sa më pak dhimbje, madje edhe hiç. Është një lindje me vizualizime. Përgjithësisht, përmes lindjes me hipnozë, gratë janë më të relaksuara dhe i përkushtohen procesit të mitrës dhe bebes.

Gratë përgatiten paraprakisht, andaj kanë njohuri për fazat e lindjes dhe atë se si ta qetësojnë veten përmes frymëmarrjes, lëvizjes dhe hipnozës. Janë të afta të marrin vendime të vetëvendosura.

**Pos kësaj metode, me çfarë tjetër merresh?**

- Merrem me zhvillimin personal, që përfshin aspektet e shëndetit fizik, emocional, mendor dhe energjik. I udhëzoj klientët në procesin e dëshiruar të ndryshimit të tyre në mënyrën më efikase. Përdor metoda të ndryshme si hipnoze, NLP etj.

**A keni ordinancë a qendër tuajën të punës?**

- Po, kam ordinancën time, e cila gjendet në Spreitenbach. Aty mirëpres klientët për seanca.

**Valentinë, cila është filozofia jote në jetë?**

- Besoj që ekziston një fuqi hyjnore që e do secili njeri pa fund. Unë i shohë sfidat e jetës si mësim dhe si shans për të zbuluar veten në thellësi, përpos që ndjekë gëzimin tim.

**Po, njerëzit mbi çfarë filozofie, apo parimi duhet ta ndërtojnë jetën e tyre?**

- Besoj se secili duhet ta zbulojë vetveten, filozofinë dhe parimet personale. Por, çka mua më duket e rëndësishme është sinjeriteti ndaj vetvetes dhe të jenë të hapur për të mësuar gjëra të reja.

**Cili është mendimi i parë me të cilin zakonisht e nisë ditën?**

- Është emocioni i falënderimit. Them: Faleminderit. Ky është edhe mendimi i fundit me të cilin bije në gjumë.

**Si është një 24 orësh i yti?**

- Zakonisht, kur zgjohem ulem dhe meditoj, pastaj nisë ditën me angazhimet rreth fëmijëve të mi. Bëj gjërat që i bën çdo nënë. I qes fëmijët në natyrë dhe mundohem t'u mësoj gjëra të reja.

Përgatis drekën për familjen, fëmijët dhe bashkëshortin dhe investoj kohë në punën time. Lexoj, meditoj dhe falem.

Në fundjavë punoj në ordinancën time.

**Çka ke me shumicë në jetë dhe çka të mungon?**

- Kam shumë njerëz të mirë në jetën time. Kam familjen dhe, gjithashtu, bashkëshortin përkrahës. Për momentin nuk ndjej që më mungon diçka.

**Ju dukeni bukur dhe në formë, ani pse jeni mjaft e angazhuar në jetën private si nënë dhe bashkëshorte. Si ia del?**

- E dëgjoj intuitën dhe investoj energjinë time mundësisht optimale. Bëj joga sa herë që më lejon koha. Po ashtu, kam bashkëpunim dhe komunikim jashtëzakonisht të mirë me bashkëshortin tim.

**Çfarë duhet të bëjë një femër që të jetë e përmbushur?**

- Ta fitojë vetëdijshmërisht energjinë femërore në jetë. T'i lejojë vetes të ketë ëndrra të mëdha dhe të ketë besim se janë ëndrra realizuese, edhe nëse ajo ende nuk e di se si mund t'i arrijë.

**A ke ndonjë gjë që të frymëzon?**

- Për momentin më frymëzojnë më së shumti fëmijët e mi dhe gjuha e energjisë, të cilën e kuptoj gjithnjë e më mirë përmes përvojës.

**Porosia jote?**

- Ta pranojmë vetveten plotësisht, si anëtar pozitiv ashtu edhe ato negative, sepse askush nuk është perfekt. Ky është hapi i parë i ndryshimit.

Merre veten me të mirë!

**Nderim Neziri**



# Milot Rashica, baba i lumtur dhe krenar



Futbollistit të njohur, Milot Rashicës, duket se po i ka hije çanta e kopshtit, që po ia mbanë në dorë të birit.


Ai në një postim ka shpërndarë një fotografi me djalin e tij, Tianin.

Imazhet përcjellin më së miri lumturinë e futbollistit dhe të birit. Futbollisti nga Vushtrria po kalon momente të mrekullueshme me familje dhe kjo dëshmohet përmes fotove.

Vogëlushi simpatik, pa dyshim, ja ka ndryshuar jetën dhe e ka bërë një baba shumë të përkushtuar e të ndjeshëm.



# Çka i dhuron vetes **Kaltrina Ajeti?**



Pothuajse të gjithë e njohin Kaltrina Ajetin, gazetaren dhe prezantuesen e "RTK"-së, që me vite ka udhëhequr disa formate televizive.

Ajo është ideatore dhe prezantuese e emisionit "Divers", ku trajtohen tema interesante bashkë me të ftuar të profileve të ndryshme. Gazetarja, e cila, ndër tjerash, përfillet për pamjen, angazhimet në disa fusha dhe udhëtimet që bën, së fundi në "Instastory" po tregon se ia ka dhënë vetes disa ditë pushim në bregdet. Kaltrina shkëlqen edhe me poza nga plazhi...

# VIP-at tanë zgjedhin Greqinë për pushim veror



Shumë nga personat publikë të vendit tonë kanë zgjedhur Greqinë, si vendin ideal për të kaluar pushimin veror.

Bukuritë natyrore dhe plazhet janë fokusi i tyre. Disa nga figurat publike, që vizituan Greqinë ditët e fundit, janë, Luana Vjollca, Rovena Stefa, Loredana, Ledri Vula, Yll Limani. Me postimet e tyre ata qendruan shumë afër me ndjekësit, duke shfaqur momente të bukura nga pushimet që po kalojnë...

**Edona Vllasaliu-Bajoku**



# Vajza

*e mixhës Ramë,*

# kopje

*e Alba Morinës*

Alba Morina është personazh i njohur televiziv, e cila me vite ka realizuar emisione të ndryshme argëtuese dhe jo vetëm. Top-lista e prezantuar nga Alba në "KTV", ka qenë një nga programet më të ndjekura muzikore në vend.

Ka kohë që Alba është e orientuar më shumë në fushën e sportit, duke drejtuar programet sportive, por edhe duke punuar si zyrtare në FFK-së. Morina nuk e lë pas as jetën sociale, e sidomos miken e saj të ngushtë, Besa Domin.

Të dyja duken më shumë si binjake, sesa si shoqe...



## Elita Rudi i ka dy fjalë për vjehrrën e vet

Elita Rudi është gjakovare e rritur në Prishtinë, por e martuar në Pejë. Siç dihet, bashkëshorti i Elitës, reperi Asdren Gjikolli, është nga Peja, andaj tashmë lidhja e Elitës me Pejën është shumë e fortë.

Prezantuesja ka folur edhe për marrëdhënien e saj me vjehrrën e vet, për të cilën ka zgjedhur të thotë fjalët më të bukura.

Ajo ka treguar se vjehrrën e konsideron si shoqe, pasi me të flet thuajse gjithçka.

Dhe, jo veç shoqe, por e quan edhe nënë.

**D. H.**

# A u ka marrë malli për Agnesa Vuthajn?



Ish-“Miss Peja”, “Miss Kosova” e “Miss Albania” dhe përfaqësuesja e Shqipërisë në “Miss world”, vazhdon të shkëlqej.

Për një kohë të gjatë Agnesa Vuthaj kishte jetë aktive në fushën e modelimit dhe në aspektin medial, por jo më. Ka kohë që Agnesën nuk e kemi parë të përfshirë në kampanja, apo aktivitete të ndryshme. Megjithatë, ajo vazhdon të duket e freskët, e bukur dhe tamam mis. Dhe, nëse u ka marrë malli për Agnesën, ja një galeri fotosh të bukuroshes...

**N. N.**





**Giardino**  
LUXURY APARTMENTS



*Bukuri mbreslënse e luksi  
në apartmans Giardino Lux ...  
Ku tjetër në, Ullqinin e bukur!*



+382 69 241 341  
+382 69 606 208

 /giardinolux





## *Në dasmën e asaj që e dashuroja* **isha kamerier!**

*Në dasmën e asaj që e dashuroja punova kamerier dhe pas orarit të punës kam qarë deri në mëngjes...*

Si shumë të rinj edhe unë i fillova studimet. Dhe, që në ditën e parë, në korridorin e gjatë të fakultetit, pashë një fytyrë të bukur, aq sa i gjithë trupi mu rrëqeth në ato çaste dhe i thashë vetes kjo fytyrë do t'më ndjek gjithë jetën.

Por, edhe pse kalonin javët, muajt, vitet, e edhe pse kaloja me femra, fytyra e saj nuk më hiqej dot nga mendja, por nuk kisha guxim dot t'ia shpalosja ndjenjat që kisha për të. Tek në vitin e dytë të studimeve filloja t'ia jepja disa shenja se isha marrëzisht i dashuruar në të.

Por, shumë shpejt e kuptova se ajo ishte e fejuar, ashtu siç isha edhe unë i fejuar me mesit që në bankat e shkollës së mesme.

Një ditë, teksa pinim kafe bashkë në bufenë e fakultetit tonë, më tregoi shumëçka që përjetonte me të fejuarin e saj.

### **NUK MË LËNDOJ KUSH MË SHUMË SE AJO!**

Dhe, kur përfundoi rrëfimin, deri në atë çast nuk ka pasur njeri të më lëndoj më shumë se ajo...

Andaj, ditëve në vijim ishim gjithnjë e më shumë bashkë...

E, në vitin e tretë të studimeve erdhi koha që i thashë të ndahet nga i fejuari, në mënyrë që të pushojnë njëherë e përgjithmonë vuajtjet e saj dhe të fillojmë një jetë të re...

Ndërkohë, po atë ditë e fejuara ime kërkoi të jemi bashkë në vizitën që e kishte caktuar te një gjinekolog, sepse kishte probleme gjinekologjike.

Dhe, për habinë time, mjeku i tha se ishte shtatzënë. E, unë në ato çaste nuk kisha nevojë që ajo të lindte fëmijë, sepse zemra ime tashmë rrihte për tjetërkënd.

I thashë të fejuarës se nuk ishim të gatshëm të kemi fëmijë, se duhej të abortoj, se...

Por, e fejuara ime as që donte t'më dëgjonte, e lëre më të abortonte. Madje, ma bëri me dije se duheshim të martoheshim me procedurë të

shpejt, meqë foshnja tashmë ishte në muajin e tretë të shtatzënisë.

Dhe, si rrufeja u përhap lajmi se unë do të bëhem baba. Më uruan shokët e shoqet e fakulteti, por jo edhe ajo që i thashë të ndahet nga i fejuari i saj.

### **THIKËN MA NGULE NË ZEMËR!**

Ajo në ato çaste vetëm më shikoi dhe sikur donte të thoshte: "Thikën ma ngule në zemër". Shpejt e shpejt u largua nga unë dhe më nuk e pashë as në fakultet.

Dhe, kur i përfundam ligjëratat, secili mori udhën e vet.

Unë u martova e ajo humbi...

Mirëpo, nuk thonë kot se jeta sjellë edhe të papritura.

E kjo më ndodhi edhe mua...

Në lokalin ku punoja gjatë verës si kamerier, një të shtunë, organizohej një dasmë e madhe.

Dhe, kur i mora pijet t'ua ofroja çiftit që martohesh, mu dridh trupi kur para meje ishte ajo...

Ajo që e doja me mish e shpirt.

Ajo, dashuria ime e madhe...

**V. Gashi**





 /white\_bubble\_hotel

# *Edhe kur u bëra burrë më rrahu baba me rrip!*

*Ata që s'e kanë ngrënë dajakun e prindërve, pak i shohin ëndërr. Pak qajnë për ta, e edhe më pak zgjohen natën...*

Sivjet muaji shtator, të cilin e pres gjithnjë me droje për shkak të fatkeqësive të ndryshme, erdhi qysh në muajin mars!

Duke i thënë vetes si shokut më besnik dhe më të ngushtë, se mund të ketë ndryshuar ky itinerar për shkak të ndryshimeve globale klimatike, ose edhe për shkak të politikave

kundërthënëse ndërsqiptare, desha t'i arsyetoja lotët që më shoqëruan një javë rresht.

Erdhi nata me dritë hëne. Koha e kësaj drite më bënte të përvidhem natën, kur flinin prindërit, për të soditur arën nën "Mollën Xufkë", që të shikoja çfarë të papriturash sillte nata...

E kisha përgatitur vendin gjatë ditës,

në degët e shpeshta të mollës, që të shikoja çdo gjë nga molla poshtë saj. Dëshira ime ishin të vinin lepujt dhe dhelprat, të cilat nuk i hanin fëmijët në mollë.

Hëna ndriçonte sikur të ishte ditë. Dhe, më në fund, babanë e zuri gjumi. U ngrita ngadalë për të dalë nga dhoma në rrugën që shpinte te molla.



Hipa në mollë, u ula në degët e saj. E kisha një skelet kasolleje në degë dhe kashtë sa për t'u shtrirë.

Kah mëngjesi më kishte zënë gjumi. Nuk di se çka kishte lëvizur nën mollë dhe nuk di nëse kishte pasur ndonjë shtojzovallë që më kishte mbrojtur gjatë gjumit...

Nëna nuk më kishte parë kur kisha dalë nga dhoma. Kishte dalë në oborr, por nuk më kishte gjetur askund.

E kishte zgjuar babën t'më kërkonte. Por, gjërat kishin shkuar aq larg, sa në mëngjes kishin dalë t'më kërkonin edhe fqinjët.

Dhe, si në "Lugjet e verdha", jehonin zërat e tyre, duke më thirrur në emër. Ishte trazuar tërë lagjja. Dhe, në fund, më kishin shpallur të humbur!

Mirëpo, gjithë atë zhurmë e përcillja nga degët e mollës, duke qeshur herë pas herë. Më dukej interesante kah më kërkonin...

Dikur, dy fqinj u ndalën nën mollë.

Flisnin se ku mund të isha tretur unë, gjatë natës...

I pari tha:

"Nëse ka dalë natën i përgjumur dhe ka shkuar kah mali, zor se do të kthehet i gjallë në shtëpi!"

E, pasi i dëgjova fjalët e tyre, desha të lëshoja një zë që t'i frikësoja, por rashë nga dega e mollës, para këmbëve të tyre.

Ata kërcyen nga frika, por të ngazëllyer që më gjetën...

Kur hymë në shtëpi, babai m'u ofrua dhe më tha: "Ku ke qenë gjithë natën?!"

A e di se gjithkund të kemi kërkuar?!" Dhe, pasi i përcolli burrat e mëhallës, hoqi rripin dhe nisi t'më rrahë...

Nëna u ofrua dhe i tha: "Ka dalë i përgjumur dhe nuk di ku ka qenë!". Unë, më në fund, e qela gojën dhe i thashë babait se nuk di ku kam qenë se isha zgjuar jerm...

## GRUAJA

### MA NGREHU VESHIN!

Zura të gjëmoja në shtrat. Dhe, pas një sërë gjëmash, gruaja më kapi për veshi e më tha:

Ç'ke, a je i sëmurë, a?! Ku të dhemb?."

Nën djersët e rripit, në jerm, i thashë se më rrahu babai me rrip. Shihma trupin si më është bërë, grua!

Ajo u ngrit në shpejtësi dhe ndezi

dritën, Dhe, në vend se t'ma shikonte trupin, më solli një gotë ujë! Isha tretur në thellësinë e ngjarjes. Isha bërë fëmijë. Isha kthyer dhjetëra vjet prapa në kohë dhe, duke folur nga pozita e të përgjumurit, e pyeta se kush ishte... Dhe, kur më tha se jam gruaja jote, o njeri, u befasova që unë, fëmija i ëndrrave, të isha me grua pranë vetes! Më dukej vetja si një tarzan i vogël në xhungël, por nuk isha në gjendje ta pija as ujin!

Pasi u lodhë me gotë në dorë, gruaja ma ktheu atë për fytyrë!

M'u kthjellën sytë dhe tek atëherë pashë se kisha qenë në ëndërr dhe nuk po hiqesha prej saj...

"A po të dhemb trupi nga rripi?!", më pyeti gruaja pas pak.

"Çfarë rripi, oj grua?! Ëndërr paskam qenë. Sa mirë që ma hodhe ujin në fytyrë!", ia ktheva.

"Njeri", më tha ajo, "ke parë kah të rrahë babai në ëndërr ashtu si para shumë vitesh dhe asgjë më shumë...". Dhe, kur e kuptova se, vërtet, kisha qenë në ëndërr, i sugjestionuar nga situata, e falënderova Zotin që nuk më rrihte babai më, por menjëherë më kaploi nostalgjia për nënën, që atëbotë më kishte shpëtuar...

Nga malli nisa të qaj. Desha të fshihja vajin, por ai shpërtheu dhe gruaja më tha:

"A mos po të rrahë përsëri babai me rrip?!"

"Jo, por tash nga nostalgjia e kam", ia ktheva.

Dhe, u ngrita nga shtrati që të mund ta derdh lotin lirshëm dhe ta liroja shpirtin. Por, diçka më shtrëngonte në fytyrë.

U ngrit gruaja në këmbë, e më tha: "Vetëm ty të ka falë Zoti t'i ëndërrorsh prindërit çdo natë. Unë nuk i shoh në ëndërr kurrë prindërit e mi dhe nuk më gjeti asgjë! I ke lodhur prindërit edhe në varre çdo natë duke ua lëkundur eshtrat".

Dhe, më bie në mend një arsyetim e iu drejtova:

"Ti nuk i sheh ëndërr prindërit, sepse nuk të kanë rrahur kurrë si fëmijë!"

## LOTËT E RADHËS...

E pata humbur çantën me libra në shkollën e mesme. Shpresoja se do e gjeja. Mbështetësja në shpresën,

se pakkush lexonte. Kush vjedh libra më?!

Për më tepër, librat i hiqnim nga shtëpia, duke i falur.

Në rastësi e sipër, e takoj vajzën që ma kishte shkruar emrin e vet në të gjitha librat që kisha blerë.

Ëndrra disi ndërroi kah, duke kaluar te një realitet kur motra ime ishte sëmurë për vdekjen e nënës.

Ajo, disi, ishte shtrirë në shtrat dhe mernte infuzion në krahun e djathtë. Shikonte si pikonin pikat nga shishja në venën e saj përmes gypit të hollë të plastikës.

Dhe, në çast, para syve më dolën dy fëmijët e saj dhe më shikonin me habi...

Por, e di se nëna vdiq me mallin e saj. Si fëmijë, i kapej nënës për dimi, kudo që shkante ajo.

"Pse nuk e more nënën, vëlla, se vetëm dora e saj ma heq këtë shishe mbi kokë dhe unë shërohem dhe bëhem e bukur si dikur kur ishim fëmijë?!"

Shko merre nënën e sille këtu!", më tha motra.

Çfarë t'i thosha?

Desha t'i thosha se nëna ka vdekur, por u përmbajta.

"Po ti, pse je këtu?!", më pyeti motra.

"E harrova çantën me libra dhe u ktheva ta marrë!", i thashë.

"A nuk ke ardhur për mua, motrën tënde, a?!", më tha.

"Për ty erdha, se më ka marrë malli, sepse qe sa vjet nuk jemi parë! Na kanë ndarë malet e larta deri në qiell!", ia ktheva.

Motra më luti t'ia heq shishen e infuzionit dhe të nisemi për në shtëpi.

E hoqa gjilpërën nga dora e saj dhe u nisëm.

Kur u kthyem në shtëpi, ajo më buzëqeshi dhe më përqafoi fort, e mua më rrodhën lotët.

Ajo me ndjenjën e përqaimit të nënës, e unë me ndjenjën e dhembjes që motra nuk do ta sheh nënën...

Dhe, kur hymë në sallën, në ballë të të cilit qëndron e varur në ram fotografia e nënës, ajo më tha:

"Ka vdekur nëna, a?!"

"Po, ka vdekur", ia ktheva.

Ajo filloi të qajë, duke i përqaftuar fëmijët e vet...

**S. Murturi**



# *Posa bëmë seks, më tha:* **Jam i martuar!**

*Jam 30-vjeçare, e ndarë nga burri. Dhe, që nga ndarja më s'kisha kontakte me askënd...*

Një natë, teksa nuk më zinte gjumi, fillova të komunikoja në internet me një mashkull, i cili mu prezantua si Vedati, nga Prishtina. Më tha se është 40-vjeçar, por ende i pamartuar. Dhe, që nga ajo natë filloi t'më dërgonte mesazhe në "Facebook".

## **NJË VJET PA BËRË SEKS FARE!**

Thënë të drejtën, qëkur isha ndarë nga burri një vit më parë, më nuk kisha kurrfarë raportesh me askund dhe kënaqesha kur flisja me të... Por, pas disa javësh ai filloi t'më tregonte në hollësi për jetën e tij dhe më tha se është i martuar, por ka probleme me grua dhe kjo gjë më shqetësoi, në radhë të parë kur pashë se ai më kishte tradhtuar, ani pse ende nuk kishim asgjë konkrete ndërmjet veti.

Sidoqoftë, kishte kohë që bëja jetën e një "beqareje" dhe ishte bukur të bisedoja me dikë natën vonë...

Por, pas disa muajsh mesazhet e tij filluan të bëheshin goxha flirtues dhe ai ma bëri të qartë se dëshironte të më kishte në shtrat...

Andaj, edhe pse i rezistova për shumë kohë, një natë, kur gruaja e tij kishte shkuar për të vizituar nënën e saj, u dorëzova marrëzisht dhe i thashë se mund të vinte te unë...

## **POSA BËMË SEKS MË THA: NUK MUND TË VAZHDOJMË TUTJE!**

Ai mbërriti në orën 12 të natës te unë. Dhe, pa u hamendur iu dorëzova. Bëmë seks...

Por, të nesërmen, ai filloi të distancohej ndaj meje dhe tha se gruaja e tij kishte nisur të dyshonte, kështu që ai

nuk mund të bisedonte më me mua!

Pas një kohe më tha se a mund të bëjmë seks përsëri nëse gruaja e tij do shkojë sërisht te nëna e saj...

Dhe, për çudi, unë pranova... Por, ai ma bëri prapë të njëjtën gjë!

U ndjeva shumë e lënduar, kështu që, kur më kërkoi për herë të tretë, e refuzova.

E, para një muaji i bëra bllok në të gjitha rrjetet sociale që të mos më kontaktojë më.

Dhe, edhe pse e di që kam bërë gjënë e duhur, nuk mundem ta heqë dot nga mendja dhe vetëm qaj.

Prandaj, shpesh i bëj pyetje vetes: Çka po ndodh me mua?!

Pse jam dashuruar kaq shumë në të, kur e di dhe e kam kuptuar se ai nuk e lë gruan për mua, por do vetëm të kënaqet me seks dhe në fund secili rrugës së vet?!

**Rifadija, Prishtinë**



ABONORA

DRYMADES



*Në Shqipërinë e jugut,  
Dhërmium e bukur!*



Rr. Perivolo, Dhërmi, Shqipëri  
+355 69 342 5090

# Flow kësaj radhe vjen me “Ferrari”



*Flow, një emër i ri në tregun e muzikës, por që premtion dhe do bëhet i dashur gjithandej, me zërin e talentin e tij.*

Kështu shkruhej kur e lansoi këngën e parë. Dhe, ashtu doli, reperi i ri po pëlqehet jashtëzakonisht nga publiku edhe me klipin e dytë “Ferrari” që u plasua këto ditë, shkruan Kosovarja.

Kënga është prodhim i Granit Gashit dhe Darddy sa i përket muzikës, kurse, klipi u bë nga Laurat Gashi.

Vlen të përmendim se Flowi me zërin dhe performancat

e tij të veçanta që tani ka rrëmbyer zemrat e gati se çdo shqiptari.

Planet e tij janë të shumta, por Flow për momentin nuk preferon të zbulojë diçka, por premtion që do t’vi me shumë surpriza dhe se nuk do ndalet.

I ri po, vokal të veçantë po, talent po, pse t’ mos vazhdojë dhe të sjell surpriza të reja.







**Boat Trip**  
*Don't forget this summer!*



 /canyonmatka\_

TEL: +38970726265





# Çka na mallkon Syri i Keq?

*Historia e mallkimit vazhdon dhe besohet edhe në ditët e sotme...*

Syri i Keq është vështrim njerëzor, që besohet se i shkakton dëm dikujt apo diçkaje. Dëmi i mbinatyrshëm mund të vijë në formën e një fatkeqësie, një sëmundjeje serioze, lëndimit, madje edhe vdekjes.

Simptomat e sëmundjes së shkakuar nga Syri i Keq përfshijnë humbjen e oreksit, zverdhjen e tepruar të lëkurës, lehmë, të vjella dhe temperaturë të lartë.

Nëse objekti i sulmuar është një lopë, qumështi i saj mund të shterë; nëse është një bimë apo pemë frutore, ajo mund të thahet papritmas.

Syri i Keq shkakton, gjithashtu, një sërë sëmundjesh të tjera, përfshirë pagjumësinë, lodhjen, depresionin dhe diarrenë.

Gati çdo gjë që shkon keq, mund të shpjegohet me fuqinë e Syrit të Keq. Ky fenomen është i mirënjohur gjatë gjithë historisë.

Ai vërehet edhe në Kuran, por edhe në dramën e Shekspirit. Edhe pse besimi te Syri i Keq është i përhapur, ai nuk është universal.

Syri i Keq është, në thelb, një lloj specifik i mallkimit nëpërmjet magjisë dhe i ka rrënjët te besëtytnitë. Marrim shembullin e një njeriu fatkeq, me probleme të vazhdueshme shën-

detësore, që ka pësuar një aksident të rëndë, apo është prekur nga një sëmundje infektive.

Përpara se shkenca të shpjegonte modelin e motit dhe teorinë e mikrobeve, çdo ngjarje e keqe për të cilën nuk kishte një shkak të dukshëm, shpjegohej me një mallkim.

Mallkimet, duke përfshirë edhe Syrin e Keq, janë një përgjigje ndaj pyetjes shumë të vjetër, se pse njerëzve të mirë u ndodhin gjëra të këqija. Thuhet se sytë kanë fuqi të veçanta, pasi janë "porta e shpirtit" të një njeriu.

## PSE I PREKË FËMIJËT SYRI I KEQ?

Besohet se foshnjat e porsalin-dura dhe fëmijët, janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj dëmeve që mund të sjellë Syri i Keq. Ndaj, në shumë vende të botës, lëvdimi publik i një fëmije konsiderohet ndonjëherë si një tabu, pasi komplimenti do të tërheqë vëmendjen e Syrit të Keq. Për të shmangur syrin e keq, prindërit e një fëmije të lavdëruar, mund t'i kërkojnë personit që ka bërë komplimentin që ta pështyjë menjëherë në fytyrë fëmijën.

Fëmijët mbrohen nga Syri i Keq

përmes hajmalive të mbështjella brenda veshjeve të tyre, të cilat, për shembull, në Itali përbëhen nga çanta të vogla pëlhere të kuqe (nganjëherë në formë zemre), që duken si jastëkë dhe që përmbajnë një figurë (imazhin e një shejtori), një bri të vogël prej ari, kthetrat e gaforres, apo një copë hekuri.

## KUSH E KA SYRIN E KEQ?

Shumë njerëz besojnë se për të pasur Syrin e Keq nuk është i nevojshëm ndonjë qëllim i keq. Ndaj, disa njerëz mund ta kenë Syrin e Keq edhe pa e ditur këtë.

E, nëse një person besohet se e ka Syrin e Keq, edhe anëtarët e tjerë të familjes së tyre shihen shpesh me dyshim.

Mënyra më e mirë për t'u përballur me Syrin e Keq është ta shmangni atë nëse keni mundësi. Dhe, metodat në këtë rast ndryshojnë sipas kulturës, rajonit gjeografik dhe preferencës personale.

Kundër Syrit të Keq mund të përgatiten edhe ilaçe dhe magji. Hudhra përdoret shpesh për të penguar Syrin e Keq dhe disa besojnë se vetëm duke thënë fjalën "hudhër" ajo ofron mbrojtje.





**PARA**

**PAS**



**20 SEANCA**

**-13 KG**

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht priten që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

# Cilat shenja të horoskopit nuk të japin as kafe?

*Disa shenja të zodiakut duket se, zakonisht, janë dorështrënguar. Më poshtë do t'i shihni me detaje këto shenja dhe mund t'u bëjnë përshtypje disa...*

*Shenjat më koprrace të Horoskopit, e që u dhimbset t'u qesin bile një kafe, janë:*

## DEMI

Demi është shumë i kujdesshëm që të shpenzojë paratë e tij. Për të bërë një

blerje shikon me detaje disavantazhet, avantazhet, ndërsa pyet edhe disa persona të afërt derisa të marrë vendimin për të blerë diçka. Gjithashtu, Demi është gjithmonë në kërkim të ofertave dhe nuk i pëlqen ata që kanë para.

Kështu që, bëni kujdes nëse dilni me Demin. Ta dini se ka shumë mundësi që ai të mos u trajtojë...

## BINJAKËT

Binjakët e kanë problem kursimin, ndaj kur do të shpenzojë para mund të arrijë kufijtë e koprracisë. Ata janë nga ata që nuk lënë bakshish, pasi besojnë se tashmë janë llastuar mjaftueshëm për ushqimin dhe pijen.

## LUANI

Me Luanët çështja është paksa e komplikuar, pasi në shoqëri ai dëshiron të

kalojë kohë. Megjithatë, ai e bën këtë, sepse dëshiron që të gjithë ta shohin dhe të flasin për të fjalët më të mira. Nëse Luani trajton në ditët në vijim, ai humbet, pasi nuk dëshiron të shpenzojë më para për trajtimin.

## BRICJAPI

Bricjapi nuk dëshiron t'i shpenzojë pa nevojë paratë e tij. Në supermarket, gjithsesi, nuk do të marrë gjëra të panevojshme. Mund të mos jetë në shoqëri, por duhet ta dini se paratë i ka gjithmonë mënjanë.

Sigurisht, ajo që mund ta zemërojë tjetrin është se ai do të shkojë të blejë diçka të shtrenjtë për vete. Nëse ngritni çështjen e koprracisë tek një Bricjap, ai do t'u thotë se i bën paratë e tij me vështirësi dhe nuk dëshiron t'i shpërdorë ato në mënyrë të panevojshme.





**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **Pse nuk më beson burri për asgjë?**

Zonja magjistare, jam 41-vjeçare, nënë e katër fëmijëve, kam qenë e punësuar për shumë vite, por tani jam pa punë.

Dy fëmijët e mëdhenj e kanë kryer fakultetin, edhe burri është me fakultet, por kam problem se ai nuk më beson për asgjë. Kjo më vret shumë, pasi tash edhe fëmija më thonë pse babi nuk e ka besimin në ty.

Nuk më lë akoma të shkoj te nëna ime vetë, nuk më lë të dal vetë dhe shumë gjëra të tjera. Edhe shoqet më thonë se ai e tepron me këto gjëra, por nuk po kam çka të bëj.

Të lutem, a ka ndonjë mundësi që ta ndryshoj këtë gjendje bashkëshortore, sepse ndihem shumë e brengosur?

**“Pabesia vret”**

### **Përgjigje:**

*Ju nuk keni jetuar gjithnjë me këtë pabesim. Kjo ka ndryshuar para katër vitesh kur ti je detyruar ta lësh punën.*

*Dhe, kur them se je detyruar të tërhiqesh, kam parasysh se ke qenë në aksin rrugor pa ta-*

*bela orientuese: punë, burrë a familje.*

*Pse dhe si kanë ndodhur këto gjëra nuk po hyj më thellë, por nëse do më shumë detaje, më shkruaj në e-mail dhe t'i them të gjitha, edhe pse ti e di tërësisht problemin.*

*Burri nuk ka treguar pabesi, por ka treguar shumë burrëri që sot je aty. Ndoshta pas asaj që ka ndodhur më nuk është dashur të merr vendime kaq strikte për liritë tua, sepse kur ndodh diçka liria e humbë kuptimin...*

### **A do të kem fëmijë?**

Zonjë, të përshëndes shumë dhe u dëshiroj jetë të gjatë e shëndet. Jam H. M., 38-vjeçare, e martuar qe 17 vjet, por ende nuk kam fëmijë.

Jam tepër e brengosur për jetën time, sepse vitet po shkojnë dhe ka filluar presioni ndaj meje në shtëpinë e burrit. Vjehrra është ajo që po do më së shumti t'i gjej burrit grua tjetër dhe më ka thënë ti rri këtu, nuk të largon askush... Por, unë nuk mund ta duroj tjetrën pranë meje...

Jam në hall dhe nuk di çfarë hapa të marrë për të ardhmen.

Një herë kam pasur shtatzëni dhe kam abortuar në muajin e katërt. Falë terapisë tënde mbeta shtatzënë, por abortova pas një lëndimi dhe prej atëherë më nuk kam pasur shtazani, do të thotë prej asaj kohe po bëhen 7 vjet. Të lutem, çka të ndërmarr? Të rri apo të shkoj dhe a do të kem fëmijë apo jo?

**“Lutja e fundit”**

### **Përgjigje:**

*Do e kesh një fëmijë. Nuk do të arrijë askush të ta sjellë tjetrën në shtëpi për mungesë fëmije, prandaj ke durim dhe vera që vjen do të të përcjellë me një gëzim të madh, por ke kujdes që ta ruash shtatzëninë. Shoh se po rri pranë një fëmije që do ta kesh me emër të Allahut xh. h. dhe do të bëhesh e lumtur. Zoti ka fuqinë për t'u bërë të lumtur dhe të gëzuar në këtë plan, sepse edhe burri yt është në presion prej familjarëve të vet për të bërë martesë tjetër.*

### **A do ta takoj vajzën që e lashë?**

Zonjë, jam lexuese jotja e rregullt, jetoj në rrethin e Gjilanit. Jam nënë që nuk kam fëmijë, por dikur, para 25 vitesh, e kam lënë një vajzë, të cilën nuk kisha mundësi ta kisha pranë vetes. E, braktisja e saj më ka venitur shumë, motër e dashur, sa jam gjithnjë me lot në sy për të. Ajo është rritur, me siguri, e ndoshta edhe është martuar e bërë nënë, e unë nuk di gjë për të.

E kam plotësuar kartonin e asaj kohe për të mos u takuar, edhe



pse e kam kërkuar, por nuk kam mundur t'i bie në gjurmë. Shpresoj të jetë mirë dhe unë, që më nuk më fali Zoti fëmijë, e kam paguar dënimin, edhe pse nuk ndjehem fajtores. Të lutem, motër e dashur, a mund të më thuash se ku është vajza ime tash, a jeton mirë, a di ajo që nuk jeton pranë nënës së vet? A do ta kem fatin ta takoj vajzën ndonjëherë apo jo?

**"Loti-lotin"**

**Përgjigje:**

*Ajo që unë shoh nga kjo çka keni shkruar është se do të takoheni. Do të takoheni në një të ardhme të afërt, brenda tre vjetësh. Zoti i madhërishtëm do ta plotësojë dëshirën që ta takosh fëmijën tënd, e që kushtet ta kanë diktuar ta lësh, sepse nuk ka nënë që heqë lehtë dorë nga fëmija. E ke thënë mirë se për atë që e ke lënë mund të jesh dënuar... por për dëshirën dhe ndjenjën që ke Allahu xh. h. do të ta ofrojë mundësinë të shihen. Besoj se ke çka t'i thuash vajzës kur ta takosh dhe besoj se ajo do të të do si nënë, edhe pse nuk jeni parë asnjëherë, që nga lindja e saj...*

**Pse nuk po e dua burrin?**

Zonjë, jam 27-vjeçare, e martuar qe një vit. Kemi kaluar me burrin dy vite dhe jemi dashur shumë. Ai ende më do dhe nuk ka hequr dorë kurrë t'më dojë mua si nga dita e parë, për çka më bën më së shumti obliguese ta dua edhe unë. Por, te unë gjërat nuk janë në rregull. Tri herë jam larguar

prej tij dhe jam ndarë me iniciativën time, e duke më lut ai që të jetojmë bashkë. Më vjen si me vrull një ide se unë aty nuk kam jetë dhe kërkoj ndarjen prej tij e pastaj, pas një jave, në shtëpi te babai më vjen ideja të kthehem se e kam gabim që po kërkoj ndarje.

Tri herë më është përsëritur ky proces dhe tani më ka thënë burri se po dole edhe një herë nga shtëpia më nuk do të bashkohemi.

Mua më vjen akoma ky vrull, por po përmbahem e në momentet e tilla po shtrihem në dhomën time duke u bërë se jam e sëmurë.

Të lutem, më ndihmo! A do të jetojmë bashkë me burrë dhe a do të kemi jetë të mirë? A do të kemi fëmijë dhe kur, sepse ndoshta fëmija do t'më përshtatin edhe mua aty në atë shtëpi?

**"Shtegtarja"**

**Përgjigje:**

*Ju keni magji në shtëpi dhe pa e hequr magjinë nuk do të rehatoheni. Keni një fustan të prerë dhe një xhakëtë të bardhë, të cilat nuk i ke veshur që nga ditët kur je bërë nuse, prandaj gjeji dhe largoji nga shtëpia. Ato prerje janë bërë për qëllime të tilla dhe nga xhaketa është marrë një copëz e vogël që i ka shërbyer ndokujt për qëllime të liga. Posa t'i largosh prej shtëpisë do të ndryshojë gjendja jote shpirtërore dhe psikike dhe dashuria ndaj burrit do të rritet në përmasat e normales që keni pasur. Ju e dini se magjitë janë reale*

## PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

*dhe pasojat prej tyre janë evidente dhe në varësi kush për kë dhe sa ato godasin dhe krijojnë gjendje labile në mesin e bashkëshortëve.*

**Fati më është bllokuar!**

Përsëritet zonja magjistare, jam 18-vjeçare, shumë e bllokuar në suksese dhe në fat. Kam pasur tri fejesa dhe kam dështuar në të tria, pa bërë akoma martesë.

I fejuari i parë më ka vdekur, ndërsa dy të tjerët më kanë ikur pa ndonjë arsye. Prandaj, edhe jam kompleksuar, për çka kërkoj prej teje t'më tregosh nëse kam arsye apo jo të kërkoj fejesë të re apo bashkim me ndokënd.

Të lutem, më jep përgjigje ashtu qysh i sheh gjërat te unë, por të dhënat mos i publiko...

**"E mërzitura"**

**Përgjigje:**

*Nuk shoh se ka vend për kompleksim tëndin, sepse edhe të tri dështimet kanë qenë një rastësi dhe asgjë më shumë se kaq. Ndryshe prej shumë të tjerave që kanë pasur shumë më shumë lidhje sesa ti, ti i ke pasur tri lidhje që kanë sjell tri procese dhe po aq dështime që nuk janë bërë me fajin tënd.*

*Shoh se ju vjen fejesa e re në muajin prill të vitit 2023 dhe do të keni vendosje të jetës bashkëshortore.*





Është koha të bëheni  
me banesë të re!

**-10%**

**ZBRITJE**



**Kujtimet e bukura fillojnë këtu...**

**Kompleksi Dardania – Prizren**



f i g [www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)





Contact- Reception - +38260008002  
tel. +38269610003 +38269607865  
[hotel.continental.ulcinj@gmail.com](mailto:hotel.continental.ulcinj@gmail.com)  
 /hotel\_continental\_ulcinj





# SHERWOOD

*Resorts and Hotels*



**SHERWOOD  
EXCLUSIVE KEMER**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE LARA**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
DREAMS RESORT**  
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE  
BELEK**  
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD  
SUITES RESORT**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
GREENWOOD RESORT**  
KEMER / ANTALYA